



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.22**

**21 mars**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 378 datë 24.2.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës për transferimin e personave të dënuar” .....	783
Ligj nr.10 379 datë 24.2.2011	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e bashkuar “Për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive” .....	785
Ligj nr.10 380 datë 24.2.2011	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për sigurinë bërthamore” .....	800
Ligj nr.10 382 datë 24.2.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Danimarkës për bashkëpunimin për zhvillim” .....	809
Vendim i KM nr.192, datë 9.3.2011	Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit, pronarëve, në të holla, për vitin 2011 .....	815

**LIGJ**  
**Nr.10 378, datë 24.2.2011**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË BELGJIKËS PËR TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës për transferimin e personave të dënuar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6915, datë 8.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

**MARRËVESHJE**  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË BELGJIKËS MBI  
TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR

Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Belgjikës,  
*të interesuara* për nxitjen e marrëdhënieve të miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet të dyja shteteve dhe në veçanti forcimin e bashkëpunimit ligjor;

*me dëshirën* për të zgjidhur me marrëveshje të përbashkët çështjet në lidhje me transferimin e personave të dënuar, duke respektuar ndërkohë parimet themelore të të drejtave të njeriut të pranuar botërisht;

*me dëshirën* për të lejuar personat e dënuar të vuajnë periudhën e tyre të burgimit në vendin e të cilit janë shtetas, me qëllim lehtësimin e riintegritimit të tyre social;

*të vendosura* në këtë frymë, për të ruajtur në nivelin më të lartë të mundshëm, përveç rregullave dhe kushteve të Konventës europiane mbi transferimin e personave të dënuar, të nënshkruar në Strasburg më 21 mars 1983, edhe bashkëpunimin e ndërsjellë në transferimin e personave të dënuar me heqje lirie, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

**Dispozitë e përgjithshme**

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Marrëveshje interpretohen brenda kuptimit të Konventës europiane mbi transferimin e personave të dënuar, të nënshkruar në Strasburg më 21 mars 1983.

Neni 2

**Personat e dënuar që i nënshtrohen një urdhri dëbimi ose deportimi**

1. Me kërkesën e shtetit dënuës, shteti ekzekutues, në bazë të dispozitave të këtij neni, mund të bjerë dakord mbi transferimin e një personi të dënuar pa miratimin e atij personi, kur dënimi i dhënë ndaj

këtij të fundit ose një vendim administrativ në vijim të atij dënimi, përfshin një urdhër dëbimi ose deportimi ose çdo masë tjetër, si rezultat i së cilës ai person nuk do të lejohet më të qëndrojë në territorin e shtetit dënues kur ai ose ajo lirohet nga burgu.

2. Shteti ekzekutues nuk jep miratimin e tij për qëllime të paragrafit 1 para se të ketë marrë në konsideratë opinionin e personit të dënuar.

3. Për qëllime të zbatimit të këtij neni, shteti dënues i jep shtetit ekzekutues:

a) një deklaratë që përmban opinionin e personit të dënuar në lidhje me transferimin e tij ose të saj të propozuar; dhe

b) një kopje të urdhrin të dëbimit ose deportimit ose çdo urdhër tjetër, i cili ka efektin që personi i dënuar të mos lejohet më të qëndrojë në territorin e shtetit dënues kur ai ose ajo lirohet nga burgu.

4. Çdo person i transferuar sipas dispozitave të këtij neni nuk procedohet, dënohet ose arrestohet, me qëllim zbatimin e një vendimi ose urdhri ndalimi për çdo veprë penale të kryer para transferimit të tij ose të saj, të ndryshme nga ajo për të cilën ishte dhënë dënimi që duhet të zbatohet, atij ose asaj as nuk i kufizohet liria e tij ose e saj personale për ndonjë arsye tjetër, përveç rasteve të mëposhtme:

a) kur shteti dënues e autorizon këtë: paraqitet një kërkesë për autorizim, e shoqëruar nga të gjitha dokumentet përkatëse dhe një dokumentim ligjor të çdo deklaratë të bërë nga personi i dënuar; autorizimi jepet kur vepra penale, për të cilën kërkohet ky autorizim, do të ishte subjekt ekstradimi sipas ligjit të shtetit dënues ose kur ekstradimi do të përjashtohej vetëm për arsye të masës së dënimit;

b) kur personi i dënuar që ka pasur mundësi të largohet nga territori i Shtetit ekzekutues, nuk e ka bërë këtë brenda 45 ditëve nga lirimi i tij ose i saj përfundimtar, ose nëse ai ose ajo është kthyer në atë territor pasi është larguar prej tij.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 4 të këtij neni, shteti ekzekutues mund të marrë masat e nevojshme sipas ligjit të tij, duke përfshirë procedimet në mungesë për të parandaluar çdo efekt ligjor të kalimit të kohës.

### Neni 3

#### **Zbatimi i përkohshëm**

Kjo marrëveshje është e zbatueshme për zbatimin e dënimeve të dhëna para ose pas hyrjes së saj në fuqi.

### Neni 4

#### **Dispozita përfundimtare**

1. Secili prej shteteve kontraktuese njofton tjetrin për përfundimin e procedurave të kërkuara sipas Kushtetutës së tij në lidhje me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas datës së njoftimit të fundit.

2. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të papërcaktuar kohe.

3. Çdo shtet kontraktues mund të denoncojë këtë Marrëveshje në çdo kohë. Ky denoncim do të hyjë në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit të tij nga shteti tjetër kontraktues.

Në dëshmi sa më sipër, përfaqësuesit e të dy shteteve, duke qenë të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar dhe vulosur këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje në Bruksel, më 29 korrik 2010, në gjuhën frënge, holandeze, shqipe dhe angleze, ku të katër tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

PËR MBRETËRINË E BELGJIKËS  
KRYEMINISTRI  
**Yves Leterme**

**LIGJ**  
**Nr.10 379, datë 24.2.2011**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E BASHKUAR “PËR SIGURINË E MENAXHIMIT TË LËNDËS DJEGËSE TË KONSUMUAR DHE PËR SIGURINË E MENAXHIMIT TË MBETJEVE RADIOAKTIVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Republika e Shqipërisë aderon në konventën e bashkuar “Për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive”, sipas tekstit bashkëlidhur.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6916, datë 8.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

**KONVENTA E BASHKUAR**  
**PËR SIGURINË E MENAXHIMIT TË LËNDËS DJEGËSE TË KONSUMUAR DHE SIGURINË E MENAXHIMIT TË MBETJEVE RADIOAKTIVE**

**Preambula**

**Palët kontraktuese:**

i) duke pranuar se funksionimi i reaktorëve bërthamorë gjeneron lëndë djegëse të konsumuar dhe mbetje radioaktive dhe që aplikime të tjera të teknologjive bërthamore gjenerojnë gjithashtu mbetje radioaktive;

ii) duke pranuar se të njëjtat objektiva sigurie zbatohen si për menaxhimin e lëndës djegëse të konsumuar, edhe për mbetjet radioaktive;

iii) duke riafirmuar rëndësinë ndaj komunitetit ndërkombëtar të garantimit që për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe të mbetjeve radioaktive janë planifikuar dhe zbatuar praktika të sigurta;

iv) duke pranuar rëndësinë e informimit të publikut për çështjet që lidhen me sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe të mbetjeve radioaktive;

v) duke dëshiruar të promovojnë një kulturë bërthamore efektive në të gjithë botën;

vi) duke riafirmuar se përgjegjësia përfundimtare për garantimin e sigurisë së lëndës djegëse të konsumuar bërthamore dhe të mbetjeve radioaktive i takon shtetit;

vii) duke pranuar se përcaktimi i politikës së ciklit të lëndës djegëse bërthamore i takon shtetit, disa shtete e konsiderojnë lëndën djegëse të konsumuar si një burim të vlefshëm që duhet të ripërpunohet, të tjerë zgjedhin depozitimin përfundimtar të saj;

viii) duke pranuar se lënda djegëse e konsumuar dhe mbetjet radioaktive, të cilat nuk përfshihen në këtë Konventë, pasi ato janë brenda programeve ushtarake ose të mbrojtjes, duhet të menaxhohen në përputhje me objektivat e deklaruara në këtë Konventë;

ix) duke afirmuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për forcimin e sigurisë së lëndës djegëse bërthamore dhe menaxhimit të mbetjeve radioaktive nëpërmjet mekanizmave dypalësh dhe shumëpalëshe, dhe nëpërmjet kësaj Konvente nxitëse;

x) duke i kushtuar vëmendje nevojave të vendeve në zhvillim dhe veçanërisht të shteteve më pak të zhvilluara, si dhe të shteteve me ekonomi në tranzicion dhe të nevojës për të lehtësuar mekanizmat që ekzistojnë për të ndihmuar në përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve të tyre, të vendosura në këtë Konventë nxitëse;

xi) të bindur që mbetjet radioaktive kurdoherë në përputhje me sigurinë e menaxhimit të këtyre materialeve, duhet të depozitohen në shtetin në të cilin ato u krijuan, ndërkohë duke pranuar se në rrethana të caktuara, menaxhimi i sigurt dhe efikas i lëndës djegëse të konsumuar dhe i mbetjeve radioaktive mund të nxitet nëpërmjet marrëveshjeve ndërmjet palëve kontraktuese për të përdorur instalimet në një prej tyre në interes të palëve të tjera, veçanërisht kur mbetjet rrjedhin nga projektet e përbashkëta;

xii) duke pranuar se çdo shtet ka të drejtën të ndalojë importimin e lëndës djegëse të konsumuar dhe mbetjeve radioaktive të huaja në territorin e tij;

xiii) duke mbajtur parasysh Konventën për sigurinë bërthamore (1994), Konventën për njoftimin e shpejtë të një aksidenti bërthamor (1986), Konventën për ndihmë në rastin e një aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike (1986), Konventën për mbrojtjen fizike të materialit bërthamor (1980), Konventën për parandalimin e ndotjeve detare nga hedhja e mbetjeve dhe e materialeve të tjera, të amenduar (1994) dhe instrumente të tjera ndërkombëtare që lidhen me to;

xiv) duke mbajtur parasysh parimet në përmbajtje të materialit ndërinstitucional "Standardet ndërkombëtare bazë të sigurisë për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe për sigurinë e burimeve të rrezatimeve" (1996), në bazat e sigurisë të ANEA-s me titull "Parimet e menaxhimit të mbetjeve radioaktive" (1995) dhe në standardet ndërkombëtare ekzistuese që lidhen me sigurinë dhe transportin e materialeve radioaktive;

xv) duke iu referuar kapitullit 22 të agjendës 21 të Konferencës së Kombeve të Bashkuara për mjedisin dhe zhvillimin në Rio de Zhaniero, e miratuar në 1992, e cila riafirmon rëndësinë kryesore të menaxhimit të sigurt dhe të rregullt nga pikëpamja mjedisore të mbetjeve radioaktive;

xvi) duke pranuar dëshirën e forcimit të sistemit të kontrollit ndërkombëtar të zbatuar në mënyrë specifike për mbetjet radioaktive, siç referohet në nenin 1(3) të Konventës së Bazelit për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe depozitimit të tyre (1989);

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

## KAPITULLI 1 OBJEKTIVAT, PËRKUFIZIMET DHE FUSHA E ZBATIMIT

### Neni 1 Objektivat

Objektivat e kësaj Konvente janë:

i) të arrijë dhe të ruajë një nivel të lartë mbarëbotëror të sigurisë së menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe të mbetjeve radioaktive, nëpërmjet forcimit të masave kombëtare dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, duke përfshirë, sipas rastit, bashkëpunimin teknik të lidhur me sigurinë;

ii) të garantojë që gjatë të gjitha etapave të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe mbetjeve radioaktive ekziston mbrojtje efektive ndaj rreziqeve potenciale, në mënyrë që individët, shoqëria dhe mjedisi të jenë të mbrojtur nga pasojat e dëmshme të rrezatimeve jonizuese, tani dhe në të ardhmen, në mënyrë që nevojat dhe aspiratat e brezit të tanishëm të përmbushen pa cenuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat dhe aspiratat e tyre;

iii) të parandalojë aksidentet me pasoja radiologjike dhe të zbusë pasojat e tyre kur ato ndodhin gjatë çdo etape të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar ose të mbetjeve radioaktive.

## Neni 2 Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) “Mbyllje” nënkupton përfundimin e të gjitha operacioneve në pak kohë pas vendosjes së lëndës djegëse të konsumuar ose të mbetjeve radioaktive në një instalim depozitues. Kjo përfshin punimet inxhinierike përfundimtare ose punime të tjera që kërkohen për të sjellë instalimin në kushte që ai të jetë i sigurt në planin afatgjatë.

b) “Çklasifikim” nënkupton të gjitha hapat që çojnë në çlirimin e një instalimi bërthamor, i ndryshëm nga një instalim depozitues, nga kontrolli rregullator. Këto hapa përfshijnë procesin e eliminimit të ndotjeve dhe të çmontimit.

c) “Shkarkime” nënkupton shkarkimet e planifikuara dhe të kontrolluara në mjedis, si një praktikë e ligjshme, brenda kufijve të lejuar nga organi rregullator, të materialeve radioaktive të lëngëta ose të gazta që rrjedhin nga instalimet bërthamore të licencuara gjatë funksionimit normal të tyre.

d) “Depozitim” nënkupton vendosjen e lëndës djegëse të konsumuar dhe të mbetjeve radioaktive në një instalim të përshtatshëm, pa synuar nxjerrjen e tyre nga instalimi.

e) “Licencë” nënkupton çdo autorizim, leje ose certifikatë që jepet nga enti rregullator për kryerjen e veprimtarive që lidhen me menaxhimin e lëndës djegëse të konsumuar ose të mbetjeve radioaktive.

f) “Instalim bërthamor” nënkupton një instalim civil dhe truallin, ndërtesat dhe pajisjet e lidhura me të, në të cilin prodhohen, përpunohen, përdoren, trajtohen, ruhen ose depozitohen materiale radioaktive në sasi që kërkojnë mbajtjen parasysh të sigurisë.

g) “Koha e operimit” nënkupton periudhën gjatë të cilës një instalim i menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar ose i mbetjeve radioaktive përdoret për qëllimin për të cilin është ndërtuar. Në rastin e një instalimi depozitues, periudha fillon kur në të vendoset për herë të parë lënda djegëse e konsumuar ose mbetet radioaktive dhe mbaron me mbylljen e instalimit.

h) “Mbetje radioaktive” nënkupton një material radioaktiv në formë të ngurtë, të lëngët ose të gaztë, për të cilën nga pala kontraktuese ose nga persona juridikë ose fizikë, vendimi i të cilëve pranohet nga pala kontraktuese, nuk parashikohet asnjë përdorim i mëtejshëm dhe që kontrollohet si mbetje radioaktive nga enti rregullator sipas kuadrit legjislativ dhe rregullator të palës kontraktuese.

i) “Menaxhim i mbetjeve radioaktive” nënkupton të gjitha veprimtaritë, duke përfshirë veprimtaritë mbi nxjerrjen nga përdorimi, që lidhen me trajtimin, trajtimin paraprak, trajtimin, kondicionimin, ruajtjen ose depozitimin e mbetjeve radioaktive, duke përjashtuar transportimin jashtë vendit. Ai mund të përfshijë edhe shkarkimet.

j) “Instalim për menaxhimin e mbetjeve radioaktive” nënkupton çdo shërbim ose instalim, qëllimi parësor i të cilit është menaxhimi i mbetjeve radioaktive, duke përfshirë një instalim bërthamor në procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit vetëm nëse ai është projektuar nga pala kontraktuese si instalim për menaxhimin e mbetjeve radioaktive.

k) “Organ rregullator” nënkupton çdo organ ose organe, të cilit/të cilave i/u është dhënë nga pala kontraktuese autoriteti ligjor për të rregulluar çdo aspekt të sigurisë së lëndës djegëse të konsumuar ose të mbetjeve radioaktive, duke përfshirë dhënien e licencave.

l) “Ripërpunim” nënkupton një proces ose operacion, qëllimi i të cilit është ekstraktimi i izotopeve radioaktive nga lënda djegëse e konsumuar për përdorim të mëtejshëm.

m) “Burim i mbyllur” nënkupton një material radioaktiv që është i mbyllur në mënyrë të përhershme në një kapsulë ose i lidhur fuqimisht dhe në formë të ngurtë, duke përjashtuar elementet e lëndës djegëse të reaktorit.

n) “Lëndë djegëse e konsumuar” nënkupton lëndën djegëse bërthamore që është rrezatuar dhe është nxjerrë në mënyrë të përhershme nga qendra e reaktorit.

o) “Menaxhimi i lëndës djegëse të konsumuar” nënkupton të gjitha aktivitetet që lidhen me ruajtjen e lëndës djegëse të konsumuar, duke përjashtuar transportimin jashtë vendit të ruajtjes. Ai mund të përfshijë edhe shkarkimet.

p) “Instalim i menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar” nënkupton çdo pajisje ose instalim, qëllimi parësor i të cilit/ës është menaxhimi i lëndës djegëse të konsumuar.

q) “Shtet i destinacionit” nënkupton një shtet në të cilin është planifikuar ose po kryhet një lëvizje ndërkuftare.

r) "Shtet i origjinës" nënkupton një shtet nga i cili është planifikuar të fillojë ose ka filluar një lëvizje ndërkuftare.

s) "Shtet i tranzitit" nënkupton një shtet i ndryshëm nga shteti i origjinës ose shteti i destinacionit, nëpër territorin e të cilit është planifikuar ose po kryhet një lëvizje ndërkuftare.

t) "Ruajtje" nënkupton mbajtjen e lëndës djegëse të konsumuar ose të mbetjeve radioaktive në një instalim që siguron kontrollin, me synim lëvizjen e tyre;

u) "Lëvizje ndërkuftare" nënkupton çdo dërgesë të lëndës djegëse të konsumuar ose të mbetjeve radioaktive nga shteti i origjinës tek shteti i destinacionit.

### Neni 3

#### Fusha e zbatimit

1. Kjo Konventë zbatohet ndaj sigurisë së menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar, kur lënda djegëse e konsumuar rrjedh nga operimi i reaktorëve bërthamorë civilë. Lënda djegëse e konsumuar që mbahet në instalimet ripërpunuese si pjesë e aktiviteteve ripërpunuese nuk mbulohet nga zbatimi i kësaj Konvente, nëse pala kontraktuese nuk deklaron se ripërpunimi është pjesë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar.

2. Kjo Konventë zbatohet ndaj sigurisë së menaxhimit të mbetjeve radioaktive që rrjedhin nga aplikimet civile. Megjithatë, kjo Konventë nuk zbatohet ndaj mbetjeve që përmbajnë vetëm materiale radioaktive, të cilat ndodhen në natyrë dhe nuk rrjedhin nga cikli i lëndës djegëse bërthamore, nëse ato nuk përbëjnë një burim të konsumuar ose nuk deklarohen si mbetje radioaktive për qëllimet e kësaj Konvente nga pala kontraktuese.

3. Kjo Konventë nuk zbatohet ndaj sigurisë së menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar ose mbetjeve radioaktive brenda programeve të mbrojtjes ose ushtarake, nëse nuk deklarohet si lëndë djegëse e konsumuar ose mbetje radioaktive për qëllimet e kësaj Konvente nga pala kontraktuese. Megjithatë, kjo Konventë zbatohet për sigurinë e lëndës djegëse të konsumuar ose mbetjeve radioaktive nga programet e mbrojtjes ose ushtarake nëse dhe kur materiale të tilla transferohen në mënyrë të përhershme dhe menaxhohen tërësisht brenda programeve civile.

4. Kjo Konventë zbatohet edhe ndaj shkarkimeve, siç parashikohet nga nenet 4, 7, 11, 14, 24 dhe 26.

## KAPITULLI 2

### SIGURIA E MENAXHIMIT TË LËNDËS DJEGËSE TË KONSUMUAR

#### Neni 4

#### Kërkesat e përgjithshme të sigurisë

Çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për të garantuar që në të gjitha etapat e menaxhimit të lëndës djegëse, individët, shoqëria dhe mjedisi të jenë të mbrojtura në nivel të mjaftueshëm nga rreziqet radiologjike.

Duke vepruar kështu, çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur:

i) për të garantuar që kriticiteti dhe heqja e nxehtësisë së mbetur të prodhuar gjatë menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar të jenë trajtuar në nivel të mjaftueshëm;

ii) për të garantuar që prodhimi i mbetjeve radioaktive të lidhura me menaxhimin e lëndës djegëse të konsumuar të jetë ruajtur në minimumin e mundshëm, në përputhje me llojin e politikës së lëndës djegëse të miratuar;

iii) për të marrë parasysh ndërvarësinë ndërmjet hapave të ndryshëm në menaxhimin e lëndës djegëse të konsumuar;

iv) për të siguruar mbrojtjen efektive të individëve, shoqërisë dhe mjedisit, duke zbatuar në nivel kombëtar metoda mbrojtëse të përshtatshme të miratuara nga organi rregullator në kuadrin e legjislacionit të tij kombëtar, i cili është në përputhje me kriteret dhe standardet e miratuara në nivel ndërkombëtar;

v) për të marrë parasysh rreziqet kimike, biologjike dhe të tjera që mund të jenë të lidhura me menaxhimin e lëndës djegëse të konsumuar;

vi) për t'u përpjekur që të shmangë veprime të cilat shkaktojnë ndikime të parashikuara në mënyrë të arsyeshme te brezat e ardhshëm, më të mëdha se ato të lejuara për brezin e tanishëm;

vii) për të synuar shmangien e vendosjes së barrëve të panevojshme për brezat e ardhshëm.

#### Neni 5

##### **Instalimet ekzistuese**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të shqyrtuar sigurinë e çdo instalimi menaxhues ekzistues në kohën e hyrjes në fuqi të Konventës për atë palë kontraktuese dhe garanton që, nëse është e nevojshme, të bëhen të gjitha përmirësimet e mundshme për rritjen e sigurisë së këtij instalimi.

#### Neni 6

##### **Vendosja e instalimeve të propozuara**

1. Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të siguruar që janë hartuar dhe zbatuar procedurat për një instalim menaxhues të lëndës djegëse të konsumuar të propozuar:

i) për të vlerësuar të gjithë faktorët e lidhur me vendin, të cilët mund të ndikojnë në sigurinë e një instalimi të tillë gjatë kohës së tij të punës;

ii) për të vlerësuar ndikimet e mundshme të sigurisë së instalimit për individët, shoqërinë dhe mjedisin;

iii) për të përgatitur informacion për sigurinë e një instalimi të tillë, i cili vihet në dispozicion të publikut;

iv) për t'u konsultuar me palët kontraktuese në afërsinë e një instalimi të tillë, se sa është e mundur që ata të preken nga ky instalim dhe t'u sigurojë, me kërkesën e tyre, të dhëna të përgjithshme për instalimin, për t'i aftësuar ata të vlerësojnë ndikimet e mundshme të sigurisë së instalimit mbi territorin e tyre.

2. Duke vepruar kështu, çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për t'u siguruar që instalime të tilla nuk do të kenë pasoja të papranueshme për palët e tjera kontraktuese, duke u vendosur në përputhje me nenin 4.

#### Neni 7

##### **Projektimi dhe ndërtimi i instalimeve**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për të garantuar që:

i) projektimi dhe ndërtimi i instalimit të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar siguron masa të përshtatshme për të kufizuar ndikimet e mundshme radiologjike tek individët, shoqëria dhe mjedisi, duke përfshirë edhe ato nga shkarkimet ose çlirimet e pakontrolluara;

ii) në stadin e projektimit janë marrë parasysh planet konceptuale dhe kur është e nevojshme, kushtet teknike për nxjerrjen jashtë përdorimit të instalimit të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar;

iii) teknologjitë e përfshira në projektimin dhe ndërtimin e instalimit të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar janë mbështetur tek përvoja, testimi ose analizat.

#### Neni 8

##### **Vlerësimi i sigurisë së instalimeve**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për të garantuar që:

i) përpara ndërtimit të një instalimi të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar, duhet të kryhet një vlerësim sistematik i sigurisë dhe një vlerësim mjedisor në përshtatje me rrezikun e paraqitur nga instalimi dhe që mbulon kohën e tij të punës;

ii) përpara operimit të një instalimi të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar, duhet të përgatitet, kur çmohet e nevojshme, një version i përditësuar dhe i hollësishëm i vlerësimit të sigurisë dhe i vlerësimit mjedisor për të plotësuar vlerësimin e përmendur në paragrafin "i".

#### Neni 9

##### **Operimi i instalimeve**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për të garantuar që:

i) licenca e operimit të një instalimi menaxhues të lëndës djegëse të konsumuar bazohet në një vlerësim të duhur, siç përcaktohet në nenin 8 dhe është kusht për përmbushjen e programit të vënies në punë, duke treguar që instalimi i ndërtuar është në përputhje me projektin dhe kërkesat e sigurisë;



- ii) kufijtë dhe kushtet e operimit që rrjedhin nga testimi, përvoja e punës dhe vlerësimi, siç përcaktohet në nenin 8, përcaktohen dhe rishikohen sipas nevojës;
- iii) operimi, mirëmbajtja, monitorimi, inspektimi dhe testimi i instalimit të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar janë kryer në përputhje me procedurat e vendosura;
- iv) mbështetja inxhinierike dhe teknike në të gjitha fushat e lidhura me sigurinë vihet në dispozicion gjatë gjithë kohës së punës të një instalimi menaxhues të lëndës djegëse të konsumuar;
- v) incidentet e rëndësishme të sigurisë i raportohen në kohë entit rregullator nga mbajtësi i licencës;
- vi) janë vendosur programe për mbledhjen dhe analizimin e përvojës që lidhet me operimin dhe që rezultatet shpallen, sipas rastit;
- vii) janë përgatitur dhe përditësuar, sipas nevojës, planet për nxjerrjen jashtë përdorimit të një instalimi për menaxhimin e lëndës djegëse të konsumuar, duke përdorur informacionin e përfutur gjatë kohës së punës së instalimit dhe janë shqyrtuar nga enti rregullator.

#### Neni 10

### **Depozitimi përfundimtar i lëndës djegëse të konsumuar**

Nëse një palë kontraktuese, sipas kuadrit të saj ligjor dhe rregullator, ka projektuar lëndën djegëse të konsumuar për depozitim përfundimtar, depozitimi përfundimtar i kësaj lënde djegëse të konsumuar bëhet në përputhje me detyrimet e kapitullit 3 që lidhen me depozitimin përfundimtar të mbetjeve radioaktive.

## KAPITULLI 3

### SIGURIA E MENAXHIMIT TË MBETJEVE RADIOAKTIVE

#### NENI 11

### **Kërkesat e përgjithshme të sigurisë**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për të garantuar që në të gjitha etapat e menaxhimit të mbetjeve radioaktive, individët, shoqëria dhe mjedisi të jenë të mbrojtur në nivel të mjaftueshëm nga rreziqet radiologjike dhe rreziqe të tjera.

Duke vepruar kështu, çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur:

- i) për të siguruar që kriticiteti dhe heqja e nxehtësisë së mbetur të prodhuar gjatë menaxhimit të mbetjeve radioaktive të jenë trajtuar në nivel të mjaftueshëm;
- ii) për të siguruar që prodhimi i mbetjeve radioaktive të ruhet në minimumin e mundshëm;
- iii) për të marrë parasysh ndërvarësinë ndërmjet hapave të ndryshëm në menaxhimin e mbetjeve radioaktive;
- iv) për të siguruar mbrojtjen efektive të individëve, shoqërisë dhe mjedisit, duke zbatuar në nivel kombëtar metoda mbrojtëse të përshtatshme të miratuara nga organi rregullator në kuadrin e legjislativitetit të tij kombëtar, i cili është në përputhje me kriteret dhe standardet e miratuara në nivel ndërkombëtar;
- v) për të marrë parasysh rreziqet kimike, biologjike dhe të tjera që mund të jenë të lidhura me menaxhimin e mbetjeve radioaktive;
- vi) për t'u përpjekur që të shmangë veprime të cilat shkaktojnë pasoja të parashikuara në mënyrë të arsyeshme tek brezat e ardhshëm, më të mëdha sesa ato të lejuara për brezin e tanishëm;
- vii) për të synuar shmangien e vendosjes së barrëve të panevojshme tek brezat e ardhshëm.

#### Neni 12

### **Instalimet ekzistuese dhe praktikave të kaluara**

Çdo palë kontraktuese merr në kohën e duhur hapat e nevojshëm për të shqyrtuar:

- i) sigurinë e çdo instalimi menaxhues të mbetjeve radioaktive ekzistuese në kohën e hyrjes në fuqi të Konventës për atë palë kontraktuese dhe të sigurojë që, nëse është e nevojshme, të bëhen të gjitha përmirësimet e mundshme për rritjen e sigurisë të këtij instalimi.
- ii) rezultatet e praktikave të kaluara, me qëllim për të përcaktuar, nëse është e nevojshme, ndonjë ndërhyrje për arsye të mbrojtjes nga rrezatimi, duke mbajtur parasysh që zvogëlimi në dëmin që

rezulton nga zvogëlimi i dozës duhet të jetë i mjaftueshëm për të justifikuar dëmin dhe koston, duke përfshirë kostot sociale të ndërhyrjes.

#### Neni 13

##### **Vendosja e instalimeve të propozuara**

1. Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të siguruar që janë hartuar dhe zbatuar procedurat për një instalim menaxhues të mbetjeve radioaktive të propozuar:

i) për të vlerësuar të gjithë faktorët e lidhur me vendin, të cilët mund të ndikojnë në sigurinë e një instalimi të tillë gjatë kohës së tij të punës, si dhe të një instalimi depozitues pas mbylljes;

ii) për të vlerësuar ndikimet e mundshme të sigurisë së një instalimi të tillë për individët, shoqërinë dhe mjedisin, duke mbajtur parasysh zhvillimin e mundshëm të kushteve të vendit të instalimit depozitues pas mbylljes;

iii) për të përgatitur informacion për sigurinë e një instalimi të tillë, i cili i vihet në dispozicion publikut;

iv) për t'u konsultuar me palët kontraktuese në afërsinë e një pajisjeje të tillë, sesa është e mundur që ata të preken nga ky instalim dhe t'u sigurojë atyre, sipas kërkesës, të dhëna të përgjithshme që lidhen me instalimin për t'i aftësuar ata të vlerësojnë ndikimet e mundshme të sigurisë së instalimit mbi territorin e tyre.

2. Duke vepruar kështu, çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për të garantuar që instalime të tilla nuk do të kenë pasoja të papranueshme për palët e tjera kontraktuese, duke u vendosur në përputhje me kërkesat e përgjithshme të sigurisë të nenit 11.

#### Neni 14

##### **Projektimi dhe ndërtimi i instalimeve**

Çdo palë kontraktuese duhet të marrë hapat e përshtatshëm për të siguruar që:

i) projektimi dhe ndërtimi i një instalimi të menaxhimit të mbetjeve radioaktive siguron masa të përshtatshme për të kufizuar ndikimet e mundshme radiologjike tek individët, shoqëria dhe mjedisi, duke përfshirë edhe ato nga shkarkimet ose çlirimet e pakontrolluara;

ii) në stadin e projektimit janë marrë parasysh planet konceptuale dhe kur është e nevojshme kushtet teknike për çklasifikimin e instalimit të menaxhimit të mbetjeve radioaktive të konsumuara, i ndryshëm nga instalimet e depozitimit përfundimtar;

iii) teknologjitë e përfshira në projektimin dhe ndërtimin e instalimit të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar janë mbështetur tek përvoja, testimi ose analizat.

iv) teknologjitë e përfshira në projektimin dhe ndërtimin e një instalimi të menaxhimit të mbetjeve radioaktive mbështeten tek përvoja, testimi dhe analizat.

#### Neni 15

##### **Vlerësimi i sigurisë së instalimeve**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për t'u siguruar që:

i) përpara ndërtimit të një instalimi të menaxhimit të mbetjeve radioaktive të kryhet një vlerësim sistematik i sigurisë dhe një vlerësim mjedisor në përshtatje me rrezikun e paraqitur nga instalimi dhe që mbulon kohën e tij të punës;

ii) për më tepër, përpara ndërtimit të një instalimi të depozitimit përfundimtar, duhet të bëhet një vlerësim sistematik i sigurisë dhe një vlerësim mjedisor për periudhën pas mbylljes së instalimit dhe rezultatet duhet të vlerësohen sipas kritereve të vendosura nga organi rregullator;

iii) përpara operimit të një instalimi të menaxhimit të mbetjeve radioaktive duhet të përgatitet, kur çmohet e nevojshme, një version i përditësuar dhe i hollësishëm i vlerësimit të sigurisë dhe i vlerësimit mjedisor për të plotësuar vlerësimet e përmendura në paragrafin "i".

Neni 16  
**Operimi i instalimeve**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për të garantuar që:

- i) licenca për të operuar një instalim menaxhues të mbetjeve radioaktive të bazohet në një vlerësim të përshtatshëm, siç përcaktohet në nenin 15 dhe është kusht për përmbushjen e programit të vënies në punë, duke treguar që instalimi i ndërtuar është në përputhje me projektin dhe kërkesat e sigurisë;
- ii) kufijtë dhe kushtet e operimit që rrjedhin nga testimet, përvoja e punës dhe vlerësimet, siç përcaktohet në nenin 15 janë përcaktuar dhe rishikuar sipas nevojës;
- iii) operimi, mirëmbajtja, monitorimi, inspektimi dhe testimi i një instalimi të menaxhimit të mbetjeve radioaktive janë kryer në përputhje me procedurat e vendosura. Për një instalim depozitues përfundimtar, rezultatet e marra duhet të përdoren për të verifikuar dhe shqyrtuar vlefshmërinë e pranimeve të bëra dhe për të përditësuar vlerësimet siç përcaktohet në nenin 15 për periudhën pas mbylljes;
- iv) mbështetja inxhinierike dhe teknike në të gjitha fushat e lidhura me sigurinë vihet në dispozicion gjatë gjithë kohës së punës së një instalimi të menaxhimit të mbetjeve radioaktive;
- (v) janë zbatuar procedurat për karakterizimin dhe veçimin e lëndëve radioaktive;
- vi) incidentet e rëndësishme për sigurinë i raportohen në kohë organit rregullator nga mbajtësi i licencës;
- vii) janë vendosur programe për mbledhjen dhe analizimin në lidhje me përvojën e operimit dhe që rezultatet janë shpallur sipas rastit;
- viii) janë përgatitur dhe përditësuar, siç nevojitet, planet për çklasifikimin e një instalimi për menaxhimin e mbetjeve radioaktive, i ndryshëm nga një instalim depozitimi përfundimtar, duke përdorur informacionin e përfutur gjatë kohës së punës së instalimit dhe janë shqyrtuar nga organi rregullator;
- ix) janë përgatitur dhe përditësuar planet për mbylljen e një instalimi depozitues përfundimtar, sipas nevojës, duke përdorur informacionin e përfutur gjatë kohës së punës të instalimit dhe janë shqyrtuar nga organi rregullator.

Neni 17  
**Masat institucionale pas mbylljes**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për të garantuar që pas mbylljes së një instalimi depozitues përfundimtar:

- i) janë ruajtur të dhënat e vendit, projektit dhe inventarit të këtij instalimi, të kërkuara nga organi rregullator;
- ii) janë kryer kontrole institucionale aktive ose pasive, si për shembull monitorimi ose kufizimet e hyrjeve, nëse kërkohen; dhe
- iii) nëse është zbuluar gjatë çdo periudhe të kontrollit institucional, një çlirim i paplanifikuar i lëndëve radioaktive në mjedis, janë zbatuar masat ndërhyrëse, sipas nevojës.

KAPITULLI 4  
**DISPOZITAT E SIGURISË SË PËRGJITHSHME**

Neni 18  
**Masat zbatuese**

Çdo palë kontraktuese brenda kuadrit të ligjeve kombëtare, merr masa legislative, rregullatore dhe administrative dhe hapa të tjerë të nevojshëm për zbatimin e detyrimeve të saj sipas kësaj Konvente.

Neni 19  
**Kuadri ligjor dhe rregullator**

1. Çdo palë kontraktuese vendos dhe ruan një kuadër ligjor dhe rregullator për të administruar sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe të mbetjeve radioaktive.

2. Ky kuadër ligjor dhe rregullator garanton:

- i) vendosjen e kërkesave dhe rregulloreve kombëtare të sigurisë të zbatueshme për sigurinë e rrezatimeve;
- ii) një sistem licencimi të aktiviteteve menaxhuese të lëndës djegëse të konsumuar dhe të mbetjeve radioaktive;
- iii) një sistem të ndalimit të operimit të një instalimi të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar ose të mbetjeve radioaktive pa një licencë;
- iv) një sistem të një kontrolli të përshtatshëm kombëtar, të inspektimit rregullator, të dokumentimit dhe raportimit;
- v) forcimin e rregulloreve të zbatueshme dhe të kushteve të licencës;
- vi) një ndarje të qartë të përgjegjësisë të enteve të përfshira në hapat e ndryshëm të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe të mbetjeve radioaktive.

3. Palët kontraktuese marrin përgjegjësitë e duhura të objektivave të kësaj Konvente kur konsiderojnë nëse duhet të trajtojnë materialet radioaktive si mbetje radioaktive.

## Neni 20

### **Organi rregullator**

1. Çdo palë kontraktuese vendos ose përcakton një organ rregullator të ngarkuar me zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, siç përmendet në nenin 19 dhe me autoritetin, kompetencën, burimet financiare dhe njerëzore të mjaftueshme për të përmbushur përgjegjësitë e tij të përcaktuara.

2. Çdo palë kontraktuese, në përputhje me kuadrin e saj ligjor dhe rregullator, merr hapat e duhur për të garantuar pavarësinë efektive të funksioneve rregullatore nga funksionet e tjera ku organizatat janë përfshirë, si në menaxhimin e lëndës djegëse të konsumuar ose të mbetjeve radioaktive, dhe në rregulloret e tyre.

## Neni 21

### **Përgjegjësitë e mbajtësit të licencës**

1. Çdo palë kontraktuese garanton që përgjegjësia parësore për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar ose mbetjeve radioaktive mbetet mbi mbajtësin e licencës përkatëse dhe merr hapat e duhur për të garantuar që çdo mbajtës licence përmbush përgjegjësitë e tij.

2. Nëse nuk ka mbajtës të tillë licence ose palë tjetër përgjegjëse, përgjegjësia mbetet mbi palën kontraktuese e cila ka juridiksionin mbi lëndën djegëse të konsumuar ose mbi mbetjet radioaktive.

## Neni 22

### **Burimet financiare dhe njerëzore**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për të garantuar që:

- i) ka në dispozicion personel të kualifikuar, sipas nevojës, për aktivitetet e lidhura me sigurinë gjatë kohës së punës të instalimit të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe mbetjeve radioaktive;
- ii) burime financiare të mjaftueshme janë vënë në dispozicion për të mbështetur sigurinë e instalimit të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe mbetjeve radioaktive gjatë kohës së punës dhe për nxjerrjen jashtë përdorimit;
- iii) janë përgatitur dispozita financiare të cilat bëjnë të mundur kontrollin e përshtatshëm institucional dhe masa monitoruese që ato të vazhdojnë për periudhën që çmohet e nevojshme pas mbylljes së instalimit të depozitimit përfundimtar.

## Neni 23

### **Garantimi i cilësisë**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për të garantuar që janë përgatitur dhe zbatuar programe të përshtatshme të garantimit të cilësisë në lidhje me menaxhimin e lëndës djegëse të konsumuar dhe mbetjeve radioaktive.

#### Neni 24

### **Mbrojtja operationale nga rrezatimet**

1. Çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për të garantuar që gjatë kohës së operimit të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe mbetjeve radioaktive;

i) ekspozimet e rrezatimeve të punonjësve dhe publikut të shkaktuara nga instalimi duhet të ruhen në nivel aq të ulët sa mund të arrihet në mënyrë të arsyeshme, duke mbajtur parasysh faktorët ekonomikë dhe socialë;

ii) asnjë individ nuk duhet të ekspozohet, në situata normale, ndaj dozave të rrezatimit që tejkalojnë nivelet kombëtare për kufizimin e dozave, të cilat janë në përputhje me standardet e certifikuara ndërkombëtare të mbrojtjes nga rrezatimet; dhe

iii) duhet të merren masa për të parandaluar çlirimin e paplanifikuar dhe të pakontrolluar të lëndëve radioaktive në mjedis.

2. Çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për të garantuar që shkarkimet të kufizohen:

i) të ruajë ekspozimet nga rrezatimet në nivel aq të ulët sa mund të arrihet në mënyrë të arsyeshme duke mbajtur parasysh faktorët ekonomikë dhe socialë; dhe

ii) që asnjë individ nuk duhet të ekspozohet, në situata normale, ndaj dozave të rrezatimit që tejkalojnë nivelet kombëtare për kufizimin e dozave, të cilat janë në përputhje me standardet e certifikuara ndërkombëtare të mbrojtjes nga rrezatimet.

3. Çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për të garantuar që gjatë kohës së operimit të një instalimi bërthamor të licencuar, në rastin e një çlirimi të paplanifikuar ose të pakontrolluar të lëndëve radioaktive në mjedis, të zbatohen masa korrigjuese të përshtatshme për të kontrolluar çlirimin dhe për të zbutur pasojat e tij.

#### Neni 25

### **Gatishmëria në raste emergjencash**

1. Çdo palë kontraktuese garanton që përpara dhe gjatë funksionimit të një instalimi të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar ose të mbetjeve radioaktive ekzistojnë plane emergjence në vend dhe, kur është e nevojshme, edhe jashtë tij. Këto plane emergjence testohen me një nivel të përshtatshëm shpeshësie.

2. Çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për përgatitjen dhe testimin e planeve të emergjencës për territorin e tij në masën që mund të preket në rastin e një emergjence në një instalim të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar ose të mbetjeve radioaktive në afërsi të territorit të tij.

#### Neni 26

### **Çklasifikimi**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e duhur për të garantuar çklasifikimin e një instalimi bërthamor. Këto hapa garantojnë që:

i) janë në dispozicion personel i kualifikuar dhe burime financiare të mjaftueshme;

ii) janë zbatuar dispozitat e nenit 24 në lidhje me mbrojtjen operationale nga rrezatimet, me shkarkimet dhe çlirimet e pakontrolluara dhe të paplanifikuara;

iii) janë mbajtur të dhëna për informacionet e rëndësishme të çklasifikimit.

## **KAPITULLI 5**

### **DISPOZITA TË NDRYSHME**

#### Neni 27

### **Lëvizja ndërkufitare**

1. Çdo palë kontraktuese e përfshirë në lëvizjen ndërkufitare merr të gjitha hapat e duhur për të garantuar që kjo lëvizje është ndërmarrë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente dhe instrumentet ndërkombëtare detyrues përkatëse.

Duke vepruar në këtë mënyrë:

i) një palë kontraktuese që është një shtet origjine merr hapat e duhur për të garantuar që lëvizja ndërkufitare është e autorizuar dhe kryhet vetëm me njoftimin dhe pëlqimin paraprak të shtetit të destinacionit;

ii) lëvizja ndërkufitare nëpërmjet shteteve të tranzitit është subjekt i atyre detyrimeve ndërkombëtare që kanë lidhje me mënyrën e veçantë të transportit të përdorur;

iii) një palë kontraktuese, që është shtet destinacioni, jep pëlqimin për lëvizjen ndërkufitare vetëm nëse ai ka kapacitetet teknike dhe administrative, si dhe strukturat rregullatore që nevojiten për të menaxhuar lëndën djegëse të konsumuar dhe mbetjet radioaktive në përputhje me këtë Konventë;

iv) një palë kontraktuese që është shtet origjine, autorizon një lëvizje ndërkufitare vetëm nëse ajo përmbush kushtet në përputhje me pëlqimin e shtetit të destinacionit që kërkesat e nënparagrafit (iii) janë përmbushur përpara lëvizjes ndërkufitare;

v) një palë kontraktuese që është shtet origjine, merr hapat e duhur për të lejuar rihyrjen në territorin e tij, nëse një lëvizje ndërkufitare nuk është ose nuk mund të kryhet në përputhje me këtë nen, deri në realizimin e një alternative të sigurt.

2. Një palë kontraktuese nuk licencon dërgimin e lëndës së tij djegëse të konsumuar ose të mbetjeve të tij radioaktive në një destinacion jugor me gjerësi gjeografike 60 gradë për depozitim të përkohshëm ose përfundimtar.

3. Asgjë në këtë Konventë nuk cenon ose ndikon:

i) ushtrimin, me anije ose avionë, të të gjitha shteteve, të të drejtave dhe lirive lundruese detare, lumore dhe ajrore, siç parashikohet nga ligjet ndërkombëtare;

ii) të drejtat e një pale kontraktuese, tek e cila eksportohen mbetje radioaktive për përpunim me kthim ose parashikimi për kthimin e mbetjeve radioaktive dhe produkteve të tjera pas trajtimit të tyre në shtetin e origjinës;

iii) të drejtën e një pale kontraktuese për të eksportuar lëndën e saj djegëse të konsumuar për përpunim;

iv) të drejtat e një pale kontraktuese, tek e cila eksportohet lënda djegëse e konsumuar për përpunim me kthim ose parashikimi për kthimin e mbetjeve radioaktive dhe produkteve të tjera që rrjedhin nga operacionet ripërpunuese tek shteti i origjinës.

Neni 28

### **Burimet e mbyllura të konsumuara**

1. Çdo palë kontraktuese, në kuadrin e ligjeve të saj kombëtare, merr hapat e duhur për të garantuar që zotërimi, rifabrikimi ose depozitimi përfundimtar kryhet në mënyrë të sigurt.

2. Çdo palë kontraktuese lejon rikthim në territorin e saj të burimeve të mbyllura të konsumuara nëse, në kuadrin e ligjeve të saj kombëtare, ajo ka pranuar që ato të kthehen tek një fabrikues i kualifikuar për të marrë dhe zotëruar burimet e mbyllura të konsumuara.

## KAPITULLI 6

### TAKIMET E PALËVE KONTRAKTUESE

Neni 29

### **Takimet përgatitore**

1. Një takim i palëve kontraktuese zhvillohet jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

2. Në këtë takim palët kontraktuese:

i) përcaktojnë datën për takimin e parë shqyrtues, siç përmendet në nenin 30. Ky takim shqyrtues zhvillohet sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se tridhjetë ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente;

ii) përgatisin dhe miratojnë me konsensus rregullat e procedurës dhe rregulloret financiare;

iii) vendosin veçanërisht dhe në përputhje me rregullat e procedurës:

a) udhëzimet në lidhje me formën dhe strukturën e raporteve kombëtare që paraqiten sipas nenit

32;

- b) një datë për paraqitjen e këtyre raporteve;
- c) procesin për shqyrtimin e këtyre raporteve.

3. Çdo shtet ose organizatë rajonale e një integrimi ose natyrë tjetër, i cili/e cila ratifikon, pranon, miraton, aderon ose konfirmon këtë Konventë dhe për të cilën Konventa nuk ka hyrë ende në fuqi, mund të ndjekë takimin përgatitor sikur të ishte palë në këtë Konventë.

#### Neni 30

#### **Takimet shqyrtuese**

1. Palët kontraktuese zhvillojnë takime për qëllim të shqyrtimit të raporteve të paraqitura sipas nenit 32.

2. Në çdo takim shqyrtues palët kontraktuese:

i) përcaktojnë datën për takimin tjetër, që intervali ndërmjet takimeve shqyrtuese të mos kalojë tre vjet;

ii) mund të shqyrtojnë rregullat e vendosura sipas paragrafit 2 të nenit 29 dhe të miratojnë ndryshimet e bëra me konsensus, nëse nuk është parashikuar ndryshe në rregullat e procedurës. Ato gjithashtu mund të ndryshojnë me konsensus rregullat e procedurës dhe rregulloret financiare.

3. Në çdo takim shqyrtues pala kontraktuese ka një mundësi të arsyeshme për të diskutuar raportet e paraqitura nga palët e tjera kontraktuese dhe për të kërkuar sqarime për këto raporte.

#### Neni 31

#### **Takimet e jashtëzakonshme**

Një takim i jashtëzakonshëm i palëve kontraktuese zhvillohet:

i) nëse arrihet marrëveshja nga shumica e palëve kontraktuese të pranishme dhe votohet për takimin; ose

ii) me kërkesë me shkrim të një pale kontraktuese, brenda gjashtë muajve nga koha kur kjo kërkesë i është komunikuar palëve kontraktuese dhe njoftimi është marrë nga sekretariati i përmendur në nenit 37, që kërkesa është mbështetur nga shumica e palëve kontraktuese.

#### Neni 32

#### **Raportimi**

1. Në përputhje me dispozitat e nenit 30, çdo palë kontraktuese paraqet një raport kombëtar për çdo takim shqyrtues të palëve kontraktuese. Ky raport trajton masat e marra për zbatimin e çdo detyrimi të Konventës. Për çdo palë kontraktuese raporti gjithashtu trajton:

- i) politikën e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar;
- ii) praktikën e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar;
- iii) politikën e menaxhimit të mbetjeve radioaktive;
- iv) praktikën e menaxhimit të mbetjeve radioaktive;
- v) kriteret e përdorura për përcaktimin dhe kategorizimin e mbetjeve radioaktive.

2. Ky raport përfshin gjithashtu:

i) një listë të instalimeve të menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar që janë subjekt i kësaj Konvente, vendndodhjen e tyre, qëllimin kryesor dhe karakteristikat kryesore;

ii) një inventar të lëndës djegëse të konsumuar që është subjekt i kësaj Konvente dhe që është mbajtur në ruajtje dhe të asaj që është depozituar përfundimisht. Ky inventar përmban një përshkrim të materialit dhe kur është e mundur, jep informacion për masën e tij dhe aktivitetin e përgjithshëm;

iv) një inventar të mbetjeve radioaktive që janë subjekt i kësaj Konvente që:

a) është mbajtur në ruajtje në instalimin e menaxhimit të mbetjeve radioaktive dhe të ciklit të lëndës djegëse;

b) është depozituar përfundimisht; ose

c) ka rezultuar nga praktikën e kaluar.

Ky inventar përmban një përshkrim të materialit dhe informacion tjetër të përshtatshëm të përdorshëm, si vëllimi ose masa, aktiviteti dhe radiobërthamat specifike.

v) një listë të instalimeve bërthamore në procesin e të qenurit të çklasifikuara dhe statusin e veprimtarive të çklasifikuara në këto instalime.

### Neni 33 **Pjesëmarrja**

1. Çdo palë kontraktuese ndjek takimet e palëve kontraktuese dhe përfaqësohet në këto takime nga një delegat dhe nga anëtarë të tjerë si ekspertë dhe këshilltarë, si të çmohet e nevojshme.

2. Palët kontraktuese mund të ftojnë, me konsensus, çdo organizatë ndërqeveritare e cila është kompetente në lidhje me çështjet që trajtohen nga kjo Konventë, për të ndjekur si vëzhgues çdo takim ose sesion specifik të mëtejshëm. Vëzhguesve u kërkohet pranimi me shkrim dhe paraprakisht i dispozitave të nenit 36.

### Neni 34 **Raportet përmbledhëse**

Palët kontraktuese miratojnë me konsensus dhe vënë në dispozicion të publikut një dokument që trajton çështje që janë shqyrtuar dhe përfundimet e arritura gjatë takimeve të palëve kontraktuese.

### Neni 35 **Gjuhët**

1. Gjuhët e takimeve të palëve kontraktuese janë angleze, arabe, franceze, kineze, ruse dhe spanjolle, nëse nuk është parashikuar ndryshe në rregullat e procedurës.

2. Raportet e paraqitura sipas nenit 32 përgatiten në gjuhën kombëtare të palës kontraktuese që e paraqet ose në një nga gjuhët e vetme të përcaktuara për të cilat është arritur marrëveshja në rregullat e procedurës. Kur raporti është paraqitur në një gjuhë kombëtare, të ndryshme nga gjuhët e përcaktuara, sigurohet një përkthim i raportit nga pala kontraktuese në një nga gjuhët e përcaktuara.

3. Në rast mospërbushjeje të dispozitave të paragrafit 2, nëse kompensohet, sekretariati kryen përkthimin e raportit të paraqitur në një gjuhë tjetër të takimit në gjuhën e përcaktuar.

### Neni 36 **Konfidencialiteti**

1. Dispozitat e kësaj Konvente nuk cenojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese sipas ligjeve e tyre për mbrojtjen e informacionit nga zbulimi. Për qëllimet e këtij neni, "informacioni" përfshin, midis të tjerash, informacion në lidhje me sigurinë kombëtare ose me mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore, informacion të mbrojtur nga të drejtat e pronësisë intelektuale ose nga konfidencialiteti industrial ose tregtar dhe të dhënat personale.

2. Kur në kontekstin e kësaj Konvente, një palë kontraktuese siguron informacion të identifikuar nga ajo si të mbrojtur, siç përshkruhet në paragrafin 1, ky informacion përdoret vetëm për qëllimet për të cilat ai është siguruar dhe konfidencialiteti i tij duhet të respektohet.

3. Për sa i përket informacionit që lidhet me lëndën djegëse të konsumuar ose mbetjet radioaktive që hyn në fushën e veprimit të kësaj Konvente në bazë të paragrafit 3 të nenit 3, dispozitat e kësaj Konvente nuk cenojnë diskrecionin ekskluziv të palës kontraktuese për të vendosur:

i) nëse një informacion i tillë është i klasifikuar ose i kontrolluar ndryshe për t'u mbrojtur nga shpërndarja;

ii) nëse duhet të sigurojë informacion që përmendet në nënparagrafin "i" të mësipërm në kontekst të Konventës; dhe

iii) cilat kushte të konfidencialitetit i janë bashkëlidhur një informacioni të tillë, nëse ai është siguruar në kontekstin e kësaj Konvente.

4. Përmbajtja e debateve gjatë shqyrtimit të raporteve kombëtare në çdo takim shqyrtues të mbajtur sipas nenit 30 është konfidenciale.



Neni 37  
**Sekretariati**

1. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike (në vijim e referuar si “Agjencia”) i garanton sekretariatit takimet e palëve kontraktuese.

2. Sekretariati:

i) thërret, përgatit dhe kryen takimet e palëve kontraktuese të përmendura në nenet 29, 30 dhe 31;

ii) transmeton tek palët kontraktuese informacionet e marra ose të përgatitura në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente. Kostot e shkaktuara nga Agjencia për kryerjen e funksioneve të përmendura në nënparagrafët “i” dhe “ii” të mësipërm përballohen nga Agjencia si pjesë e buxhetit të saj të rregullt.

3. Palët kontraktuese, me konsensus, mund t’i kërkojnë Agjencisë të sigurojë shërbime të tjera në mbështetje të takimeve të palëve kontraktuese. Agjencia mund të sigurojë shërbime të tilla nëse ato mund të ndërmerren brenda programit dhe buxhetit të saj të rregullt. Nëse kjo nuk është e mundur, Agjencia mund të sigurojë shërbime të tilla nëse sigurohen fonde vullnetare nga burime të tjera.

**KAPITULLI 7**  
**KLAUZOLA PËRFUNDIMTARE DHE DISPOZITA TË TJERA**

Neni 38  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Në rastin e një mosmarrëveshjeje ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese që lidhen me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, palët kontraktuese konsultohen brenda kuadrit të takimeve të palëve kontraktuese, me synim zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në rast se konsultimet janë joproductive, mund të bëhet rekurs për ndërmjetësim, pajtim dhe mekanizma arbitrazhi të parashikuara nga ligjet ndërkombëtare, duke përfshirë rregullat dhe praktikatat që mbizotërojnë brenda ANEA-s.

Neni 39  
**Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi, aderimi**

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet në selinë e Agjencisë në Vjenë nga 29 shtatori 1997 deri në hyrjen e saj në fuqi.

2. Kjo Konventë është subjekt ratifikimi, pranimi ose miratimi nga shtetet nënshkruese.

3. Pas hyrjes së saj në fuqi, kjo Konventë do të jetë e hapur për aderim nga të gjitha shtetet.

4. i) Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim në bazë të konfirmimit ose aderimit nga organizata rajonale të një integriteti ose natyre tjetër, me kusht që një organizatë e tillë të përbëhet nga shtete sovraane dhe të ketë kompetencë në lidhje me bisedimet, përfundimet ose zbatimet e marrëveshjeve ndërkombëtare në çështjet që trajtohen nga kjo Konventë.

ii) Për çështjet që janë brenda kompetencave të tyre, organizata të tilla duhet që në emrin e tyre të ushtrojnë të gjitha të drejtat dhe të përmbushin përgjegjësitë, të cilat kjo Konventë u atribuon shteteve palë.

iii) Kur bëhet palë e kësaj Konvente, një organizatë e tillë i komunikon depozitarit të përmendur në nenin 43 të kësaj Konvente, një deklaratë që tregon cilat shtete janë anëtare të saj, cilat nene të kësaj Konvente zbatohen ndaj saj dhe shtrirjen e kompetencës së saj në fushën e mbuluar nga këto nene.

iv) Një organizatë e tillë nuk ka votë shtesë ndaj atyre të shteteve anëtare.

5. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit, aderimit ose konfirmimit depozitohen tek depozitari.

Neni 40  
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo Konventë hyn në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit tek depozitari, të instrumentit të njëzet e pestë të ratifikimit, pranimit ose miratimit, duke përfshirë instrumentet e pesëmbëdhjetë shteteve që kanë central elektrobërthamor operacional.

2. Për çdo shtet ose organizatë rajonale të një integrimi ose natyre tjetër, e cila ratifikon, pranon, miraton, aderon ose konfirmon këtë Konventë pas datës së depozitimit të instrumentit të fundit që kërkohet të përmbushë kushtet e vendosura në paragrafin 1, kjo Konventë hyn në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit tek depozitari të instrumentit të përshtatshëm nga një shtet ose organizatë e tillë.

#### Neni 41 **Amendimet ndaj Konventës**

1. Çdo palë kontraktuese mund të propozojë një amendament ndaj kësaj Konvente. Amendamentet e propozuara shqyrtohen në një takim shqyrtues ose në një takim të jashtëzakonshëm.

2. Teksti i çdo amendamenti të propozuar dhe arsyeja për të paraqiten tek depozitari, i cili i komunikon propozimin palëve kontraktuese të paktën nëntëdhjetë ditë përpara takimit në të cilin ai paraqitet për shqyrtim. Çdo koment i marrë për një propozim të tillë transmetohet nga depozitari tek palët kontraktuese.

3. Palët kontraktuese vendosin pas shqyrtimit për amendamentin e propozuar nëse ai duhet të miratohet me konsensus ose në mungesë të konsensusit, të paraqitet në një konferencë diplomatike. Konferenca kërkon shumicën me dy të tretat e votave të palëve kontraktuese të pranishme dhe që votojnë në takim, duke siguruar që të paktën gjysma e palëve kontraktuese të jenë të pranishëm në kohën e votimit.

4. Për të shqyrtuar dhe miratuar amendamentet e kësaj Konvente, konferenca diplomatike thirret nga depozitari dhe zhvillohet jo më vonë se një vit pas vendimit të duhur të marrë në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni. Konferenca diplomatike bën çdo përpjekje për të garantuar që amendamentet të miratohen me konsensus. Kur kjo nuk është e mundur, amendamentet miratohen me shumicën e dy të tretave të të gjitha palëve kontraktuese.

5. Amendamentet e kësaj Konvente të miratuara sipas paragrafit 3 dhe 4 të mësipërm janë subjekt i ratifikimit, pranimit, miratimit ose konfirmimit nga palët kontraktuese dhe hyjnë në fuqi për ato palë kontraktuese që kanë ratifikuar, pranuar, miratuar ose konfirmuar ato në ditën e nëntëdhjetë pas marrjes nga depozitari të instrumenteve përkatëse e të paktën dy të tretave të palëve kontraktuese. Për një palë kontraktuese e cila ratifikon, pranon, miraton ose konfirmon amendamentet në fjalë, amendamentet hyjnë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pasi palët kontraktuese të kenë depozituar instrumentet e tyre përkatëse.

#### Neni 42 **Denoncimi**

1. Çdo palë kontraktuese mund të denoncojë këtë Konventë me njoftim me shkrim tek depozituesi.

2. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga depozitari ose në një datë tjetër të mëvonshme, siç mund të përcaktohet në njoftim.

#### Neni 43 **Depozitari**

1. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë është depozitar i kësaj Konvente.

2. Depozitari informon palët kontraktuese për:

i) nënshkrimin e kësaj Konvente dhe për depozitimin e instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit, aderimit ose konfirmimit, në përputhje me nenin 39;

ii) datën në të cilën Konventa hyn në fuqi, në përputhje me nenin 40;

iii) njoftimet për denoncimin e Konventës dhe për datën që lidhet me to, në përputhje me nenin 42;

iv) amendamentet e propozuara për këtë Konventë të paraqitura nga palët kontraktuese, amendamentet e miratuara nga konferenca diplomatike përkatëse ose nga takimi i palëve kontraktuese dhe datën e hyrjes në fuqi të amendamenteve në fjalë, në përputhje me nenin 41.

Neni 44  
**Tekstet autentike**

Originali i kësaj Konvente, tekstet e së cilës në gjuhët angleze, arabe, franceze, kineze, ruse dhe spanjolle janë njëlloj autentike, depozitohet tek depozitari, i cili dërgon kopje të vërtetuara të saj tek palët kontraktuese.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesi, duke qenë i autorizuar sipas rregullave për këtë qëllim, nënshkruan këtë Konventë.

Bërë në Vjenë, më pesë shtator, një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë.

**LIGJ**  
**Nr.10 380, datë 24.2.2011**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN PËR SIGURINË BËRTHAMORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën për sigurinë bërthamore”, sipas tekstit bashkëlidhur.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6917, datë 8.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

**KONVENTA**  
**PËR SIGURINË BËRTHAMORE**

Preambula

Palët kontraktuese:

i) të ndërgjegjshme për rëndësinë ndaj komunitetit ndërkombëtar të garancisë që përdorimi i energjisë bërthamore të jetë i sigurt, i mirorganizuar dhe pa ndikime mjedisore;

ii) duke riafirmuar nevojën e vazhimit të nxitjes së një niveli të lartë të sigurisë bërthamore në shkallë ndërkombëtare;

iii) duke riafirmuar që përgjegjësia për sigurinë bërthamore qëndron mbi shtetin që ka juridiksionin për instalimin bërthamor;

iv) duke dëshiruar promovimin e një kulture efektive të sigurisë bërthamore;

v) të ndërgjegjshme që aksidentet e instalimeve bërthamore kanë potencial për ndikime ndërkufitare;

vi) duke pasur parasysh Konventën për mbrojtjen fizike të materialit bërthamor (1971), Konventën për njoftimin e shpejtë të një aksidenti bërthamor (1986) dhe Konventën për ndihmë në rastin e një aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike (1986);

vii) duke afirmuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për forcimin e sigurisë bërthamore nëpërmjet mekanizmave ekzistues dypalësh dhe shumëpalësh dhe krijimit të kësaj Konvente nxitëse;

viii) duke pranuar se kjo Konventë kërkon zotimin për zbatimin e parimeve bazë të sigurisë për instalimet bërthamore përveç standardeve të detajuara të sigurisë, dhe që ekzistojnë udhëzime sigurie të formuluar në nivel ndërkombëtar, të cilat janë përmirësuar herë pas here dhe që mund të sigurojnë udhëheqje për mjetet bashkëkohore të arritjes së një niveli të lartë sigurie;

ix) duke afirmuar nevojën për të filluar menjëherë zhvillimin e një konvente ndërkombëtare për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive sapo procesi në vazhdim për zhvillimin e bazave të sigurisë së menaxhimit të mbetjeve të rezultojë në një marrëveshje të gjerë ndërkombëtare;

x) duke pranuar dobinë e veprimtarive teknike të mëtejshme në lidhje me sigurinë e pjesëve të tjera të ciklit të lëndëve djegëse bërthamore dhe që kjo veprimtari me kalimin e kohës mund të lehtësojë zhvillimin e instrumenteve të tanishme ose të ardhshme ndërkombëtare;

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

## KAPITULLI 1 OBJEKTIVAT, PËRKUFIZIMET DHE FUSHA E ZBATIMIT

### Neni 1 Objektivat

Objektivat e kësaj Konvente janë:

i) të arrijë dhe të ruajë një nivel të lartë mbarëbotëror të sigurisë bërthamore, nëpërmjet rritjes së masave kombëtare dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, duke përfshirë, sipas rastit, bashkëpunimin teknik që lidhet me sigurinë;

ii) të vendosë dhe të ruajë një mbrojtje efektive në instalimet bërthamore kundër rreziqeve të mundshme radiologjike, me qëllim mbrojtjen e individëve, shoqërisë dhe mjedisit nga pasojat e dëmshme të rrezatimit jonizues nga këto instalime;

iii) të parandalojë aksidentet me pasoja radiologjike dhe të lehtësojë këto pasoja nëse ato ndodhin.

### Neni 2 Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Konvente:

i) “Instalim bërthamor” për çdo palë kontraktuese nënkupton çdo central bërthamor civil tokësor nën juridiksionin e saj, duke përfshirë ndërtesat për ruajtjen, përdorimin dhe trajtimin e materialeve radioaktive, të cilat janë në të njëjtin vend dhe që janë të lidhura drejtpërdrejt me punën e centralit bërthamor. Ky central pushon së ekzistuari si instalim bërthamor kur të gjitha elementet e lëndës djegëse bërthamore të jenë zhvendosur përfundimisht nga qendra e reaktorit dhe të jenë ruajtur në mënyrë të sigurt në përputhje me procedurat e miratuara dhe nga organi rregullator të jetë miratuar një program i mbylljes së tij.

ii) “Organ rregullator” për çdo palë kontraktuese nënkupton çdo organ ose organe që u jepet autoritet ligjor për dhënien e licencave dhe për të rregulluar vendosjen, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, funksionimin ose çklasifikimin e instalimeve bërthamore.

iii) “Licencë” nënkupton çdo autorizim të dhënë nga organi rregullator aplikantit që ka përgjegjësinë për vendosjen, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, funksionimin ose çklasifikimin e një instalimi bërthamor.

### Neni 3 Fusha e zbatimit

Kjo Konventë zbatohet për sigurinë e instalimeve bërthamore.

## KAPITULLI 2 DETYRIMET

### a) Dispozita të përgjithshme

#### Neni 4

#### **Masat zbatuese**

Çdo palë kontraktuese ndërmerr, brenda kuadrit të saj ligjor kombëtar, masa administrative, rregullatore dhe ligjore, si dhe hapa të tjerë të nevojshëm për zbatimin e detyrimeve të saj që rrjedhin nga kjo Konventë.

#### Neni 5

#### **Raportimi**

Çdo palë kontraktuese paraqet për shqyrtim, përpara çdo takimi të përmendur në nenin 20, një raport për masat që ajo ka marrë për zbatimin e çdo detyrimi të kësaj Konvente.

#### Neni 6

#### **Instalimet bërthamore ekzistuese**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të garantuar që siguria e instalimeve bërthamore që ekzistojnë në kohën e hyrjes në fuqi të Konventës për atë palë kontraktuese, të shqyrtohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Kur është e nevojshme në kontekstin e kësaj Konvente, palët kontraktuese garantojnë se kanë bërë të gjitha përmirësimet e mundshme praktike si një çështje urgjente për rritjen e sigurisë së instalimeve bërthamore. Nëse kjo rritje nuk mund të arrihet, zbatohen plane për mbylljen e instalimit bërthamor sa më shpejt që të jetë e mundur. Koha deri në mbyllje mund të mbajë parasysh kontekstin e plotë energjetik dhe alternativat e mundshme, si dhe ndikimin ekonomik, mjedisor dhe social.

### b) Legjislacioni dhe rregulloret

#### Neni 7

#### **Kuadri ligjor dhe rregullator**

1. Çdo palë kontraktuese vendos dhe ruan një kuadër ligjor dhe rregullator për të rregulluar sigurinë e instalimeve bërthamore.

2. Kuadri ligjor dhe rregullator parashikon:

- i) vendosjen e kërkesave dhe rregulloreve të zbatueshme të sigurisë kombëtare;
- ii) një sistem licencimi në lidhje me instalimet bërthamore dhe ndalimin e funksionimit të instalimeve bërthamore pa licencë;
- iii) një sistem të inspektimit dhe vlerësimit rregullator të instalimeve bërthamore për të siguruar përputhjen me rregulloret dhe kushtet e licencës;
- iv) zbatimin e rregulloreve përkatëse dhe të kushteve të licencës, duke përfshirë pezullimin, ndryshimin ose revokimin.

#### Neni 8

#### **Organi rregullator**

1. Çdo palë kontraktuese vendos ose cakton një organ rregullator, të cilit i besohet zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator, që përmendet në nenin 7 dhe i pajisur me autoritetin, kompetencën, burimet njerëzore dhe financiare të nevojshme për përmbushjen e përgjegjësive që i janë përcaktuar.

2. Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të garantuar një ndarje efektive ndërmjet funksioneve të organit rregullator dhe atyre të çdo organi ose organizate tjetër që lidhet me nxitjen ose përdorimin e energjisë bërthamore.

#### Neni 9

### **Përgjegjësitë e mbajtësit të licencës**

Çdo palë kontraktuese garanton që përgjegjësia kryesore për sigurinë e instalimit bërthamor qëndron mbi mbajtësin e licencës përkatëse dhe ndërmerr hapat e nevojshëm për të siguruar që çdo mbajtës licence të përmbushë përgjegjësitë e tij.

c) Konsiderata të përgjithshme për sigurinë

#### Neni 10

### **Prioritetet ndaj sigurisë**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të garantuar që të gjitha organizatat e përfshira në veprimtari që lidhen drejtpërdrejt me instalimet bërthamore përcaktojnë politika që i japin prioritet sigurisë bërthamore.

#### Neni 11

### **Burimet njerëzore dhe financiare**

1. Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të garantuar që burime financiare të nevojshme të jenë në dispozicion për të mbështetur sigurinë e çdo instalimi bërthamor gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij.

2. Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të garantuar që një numër i mjaftueshëm i personelit të kualifikuar me arsimin, trajnimin dhe ritrajnimin e duhur të jetë në dispozicion për të gjitha veprimtaritë e lidhura me sigurinë në çdo instalim bërthamor gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij.

#### Neni 12

### **Faktorët njerëzorë**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të garantuar që aftësitë dhe kufizimet e performancës njerëzore të mbahen parasysh gjatë gjithë kohëzgjatjes së një instalimi bërthamor.

#### Neni 13

### **Garantimi i cilësisë**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të siguruar që programet e garantimit të cilësisë të jenë vendosur dhe zbatuar, me qëllim për të siguruar besimin që kërkesat specifike për të gjitha veprimtaritë e rëndësishme për sigurinë bërthamore të jenë përmbushur gjatë gjithë kohëzgjatjes së instalimit bërthamor.

#### Neni 14

### **Vlerësimi dhe verifikimi i sigurisë**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të garantuar që:

i) janë kryer vlerësimet gjithëpërfshirëse dhe sistematike të sigurisë përpara ndërtimit dhe vënies në punë të një instalimi bërthamor dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij. Këto vlerësime duhet të mirëdokumentohen, të përditësohen më tej duke marrë parasysh përvojën e punës dhe informacionin e ri dhe të rëndësishëm të sigurisë, dhe të shqyrtohen nën autoritetin e organit rregullator;

ii) është kryer verifikimi nëpërmjet analizës, mbikëqyrjes, testimit dhe inspektimit për të garantuar që gjendja fizike dhe funksionimi i një instalimi bërthamor të vazhdojë të jetë në përputhje me projektin e tij, kërkesat e zbatueshme kombëtare të sigurisë dhe kushtet dhe kufijtë operacionalë.

#### Neni 15

### **Mbrojtja nga rrezatimi**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të garantuar që në të gjitha gjendjet e punës ekspozimet ndaj rrezatimit të punonjësve dhe publikut, të shkaktuara nga një instalim bërthamor, të ruhen

në nivelet më të ulëta të mundshme dhe se asnjë individ nuk ekspozohet ndaj dozave të rrezatimit, të cilat i kalojnë kufijtë e përcaktuar kombëtarë të dozave.

#### Neni 16

### **Gatishmëria në raste emergjencash**

1. Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të garantuar që ka plane emergjence brenda dhe jashtë instalimit bërthamor që janë testuar rregullisht dhe mbulojnë veprimtaritë të cilat do të kryhen në rast të një emergjence. Për çdo instalim të ri bërthamor, këto plane duhet të përgatiten dhe testohen përpara fillimit të punës së tij mbi një nivel të ulët fuqie të rënë dakord nga organi rregullator.

2. Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të garantuar që, në shkallën që ato mund të preken nga një emergjencë radiologjike, popullatës dhe autoritetet kompetent të shtetit në afërsi të instalimit bërthamor t'u jenë siguruar informacione të duhura për planifikimin dhe reagimin ndaj emergjencës.

3. Palët kontraktuese që nuk kanë instalim bërthamor në territorin e tyre, kur mund të preken në rastin e ndodhjes së një emergjence në një instalim bërthamor në afërsi, marrin hapat e nevojshëm për përgatitjen dhe testimin e planeve të emergjencës për territoret e tyre që mbulojnë veprimtaritë të cilat kryhen në rastin e ndodhjes së një emergjence të tillë.

d) Siguria e instalimeve

#### Neni 17

### **Vendosja**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të garantuar që janë vendosur dhe zbatuar procedurat e duhura:

i) për vlerësimin e të gjithë faktorëve që lidhen me vendin, të cilat mund të ndikojnë në sigurinë e një instalimi bërthamor për kohëzgjatjen e tij të planifikuar;

ii) për vlerësimin e ndikimit të mundshëm të sigurisë të një instalimi bërthamor të propozuar tek individët, shoqëria dhe mjedisi;

iii) për rivlerësimin si të nevojshëm të të gjithë faktorëve përkatës të përmendur në nënparagrafët "i" dhe "ii", në mënyrë që të garantojnë pranueshmërinë e sigurisë së vazhdueshme të instalimit bërthamor;

iv) për këshillimin e palëve kontraktuese në afërsi të një instalimi bërthamor kur ato mund të preken nga ky instalim dhe sipas kërkesës, të sigurojë informacionin e nevojshëm për këto palë kontraktuese, me qëllim që t'u japë atyre mundësinë për të vlerësuar dhe formuluar vlerësimin e vetë atyre për ndikimin e mundshëm të sigurisë në territorin e tyre të instalimit bërthamor.

#### Neni 18

### **Projektimi dhe ndërtimi**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të garantuar që:

i) projektimi dhe ndërtimi i një instalimi bërthamor funksionon për disa nivele dhe metoda të besueshme të mbrojtjes (mbrojtja në thellësi) kundër çlirimit të materialeve radioaktive, me synim që të parandalojë ndodhjen e aksidenteve dhe të lehtësojë pasojat e tyre radiologjike nëse ato ndodhin;

ii) teknologjitë e përfshira në projektin dhe ndërtimin e një instalimi bërthamor janë provuar nga përvoja ose certifikuar nga testimi ose analiza;

iii) projektimi i një instalimi bërthamor lejon një punë lehtësisht të menaxhueshme, të qëndrueshme dhe të sigurt, duke pasur parasysh veçanërisht faktorët njerëzorë dhe lidhjen e burimeve njerëzore me makineritë.

#### Neni 19

### **Operimi**

Çdo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për të garantuar që:

i) autorizimi fillestar për operimin e një instalimi bërthamor është bazuar mbi një analizë sigurie të përshtatshme dhe mbi një program të vënies në punë, që tregon se instalimi, siç është ndërtuar, është në përputhje me projektin dhe kërkesat e sigurisë;

ii) kushtet dhe kufijtë operacionale që rrjedhin nga analiza e sigurisë, testet dhe përvoja e punës janë përcaktuar dhe rishikuar si duhet, për identifikimin e kufijve të sigurt për operim;

iii) operimi, mirëmbajtja, inspektimi dhe testimi i një instalimi bërthamor kryhen në përputhje me procedurat e miratuara;

iv) janë vendosur procedurat për reagimin ndaj zhvillimit të operimit të parashikuar dhe ndaj aksidenteve;

v) projektimi i nevojshëm dhe mbështetja teknike në të gjitha fushat e lidhura me sigurinë është e disponueshme gjatë gjithë periudhës së punës së një instalimi bërthamor;

vi) janë raportuar në kohë incidentet me rëndësi për sigurinë nga mbajtësi i licencës përkatëse tek organi rregullator;

vii) janë krijuar programe për mbledhjen dhe analizimin e përvojës së punës, rezultati i arritur dhe përfundimet e nxjerra janë shpallur dhe janë përdorur mekanizma ekzistues për të ndarë përvojë të rëndësishme me organet ndërkombëtare dhe me organizata të tjera operuese dhe organe rregullatore.

viii) prodhimi i mbetjeve radioaktive që rrjedhin nga operimi i një instalimi bërthamor ruhet në minimumin e mundshëm për procesin përkatës, si në aktivitet edhe në vëllim, dhe çdo trajtim i nevojshëm dhe ruajtje e lëndës djegëse bërthamore të konsumuar dhe e mbetjeve të lidhura drejtpërdrejt me punën dhe në të njëjtin vend siç është instalimi bërthamor mban në konsideratë kondicionimin dhe depozitimin e tyre.

### KAPITULLI 3 TAKIMET E PALËVE KONTRAKTUESE

#### Neni 20

#### **Takimet shqyrtuese**

1. Palët kontraktuese zhvillojnë takime (në vijim të referuara si “takime shqyrtuese”) për qëllim të shqyrtimit të raporteve të paraqitura sipas nenit 5, në përputhje me procedurat e miratuara sipas nenit 22.

2. Sipas dispozitave të nenit 24, nëngrupe të përbëra nga përfaqësues të palëve kontraktuese mund të ngrihen dhe mund të funksionojnë gjatë takimeve shqyrtuese, siç mund të jetë e nevojshme për qëllimin e shqyrtimit të subjekteve specifike në përmbajtje të raporteve.

3. Çdo palë kontraktuese ka një mundësi të arsyeshme për të diskutuar raportet e paraqitura nga palët e tjera kontraktuese dhe të kërkojë sqarime për këto raporte.

#### Neni 21

#### **Grafiku kohor**

1. Një takim përgatitor i palëve kontraktuese zhvillohet jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

2. Në këtë takim përgatitor, palët kontraktuese përcaktojnë datën e takimit të parë shqyrtues. Ky takim shqyrtues zhvillohet sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se tridhjetë muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

3. Në çdo takim shqyrtues palët kontraktuese caktojnë datën për takimin e ardhshëm. Intervali ndërmjet takimeve shqyrtuese nuk tejkalon tre vjet.

#### Neni 22

#### **Masat procedurale**

1. Në takimin përgatitor të zhvilluar në bazë të nenit 21, palët kontraktuese përgatisin dhe miratojnë me konsensus rregullat e procedurës dhe rregullat financiare. Palët kontraktuese vendosin në veçanti dhe në përputhje me rregullat e procedurës:

i) udhëzimet që lidhen me formën dhe strukturën e raporteve që do të paraqiten sipas nenit 5;

ii) një datë për paraqitjen e këtyre raporteve

iii) procesin për shqyrtimin e këtyre raporteve.



2. Në takimet shqyrtuese palët kontraktuese, nëse është e nevojshme, mund të shqyrtojnë rregullimet e vendosura në pajtim me nënparagrafët “i”-“iii” të mësipërm dhe të miratojnë shqyrtimin me konsensus kur nuk është vendosur ndryshe në rregullat e procedurës. Ato mund të amendojnë gjithashtu me konsensus rregullat e procedurës dhe rregullat financiare.

#### Neni 23

#### **Takimet e jashtëzakonshme**

Një takim i jashtëzakonshëm i palëve kontraktuese zhvillohet:

- i) nëse kjo arrihet në marrëveshje nga shumica e palëve kontraktuese të pranishme dhe që votojnë në një takim, duke e konsideruar abstenimin si votim; ose
- ii) me kërkesë me shkrim të palëve kontraktuese, brenda gjashtë muajve kur kjo kërkesë u është komunikuar palëve kontraktuese dhe njoftimi është marrë nga sekretariati i përmendur në nenin 28, që kërkesa të jetë mbështetur nga shumica e palëve kontraktuese.

#### Neni 24

#### **Pjesëmarrja**

1. Çdo palë kontraktuese merr pjesë në takimet e palëve kontraktuese dhe përfaqësohet në këto takime nga një delegat dhe nga alternatë të tillë si ekspertë dhe këshilltarë, siç mund ta çmojë të nevojshme.

2. Palët kontraktuese mund të ftojnë, me konsensus, çdo organizatë ndërqeveritare, e cila është kompetente në lidhje me çështjet që trajton kjo Konventë për të marrë pjesë si vëzhguese në çdo takim ose sesion të tyre të posaçëm. Vëzhguesve duhet t'u kërkohej që të pranojnë, me shkrim dhe paraprakisht dispozitat e nenit 27.

#### Neni 25

#### **Raportet përmbledhëse**

Palët kontraktuese miratojnë me konsensus dhe të vënë në dispozicion të publikut një dokument që trajton çështjet e diskutuara dhe përfundimet e arritura gjatë një takimi.

#### Neni 26

#### **Gjuhët**

1. Gjuhët e takimeve të palëve kontraktuese janë gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, nëse nuk është vendosur ndryshe në rregullat e procedurës.

2. Raportet e paraqitura në bazë të nenit 5 përgatiten në gjuhën kombëtare të palës kontraktuese paraqitëse ose në një gjuhë të vetme të përcaktuar sipas marrëveshjes në rregullat e procedurës. Nëse raporti është paraqitur në një gjuhë kombëtare, e ndryshme nga gjuha e përcaktuar, pala kontraktuese siguron një përkthim të raportit në gjuhën e përcaktuar.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, nëse kompensohet, sekretariati merr përsipër përkthimin në gjuhën e përcaktuar të raporteve të paraqitura në çdo gjuhë tjetër të takimit.

#### Neni 27

#### **Konfidencialiteti**

1. Dispozitat e kësaj Konvente nuk ndikojnë te të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese në lidhje me ligjet e tyre për mbrojtjen e informacionit nga zbulimi i tij. Për qëllimet e këtij neni, “informacioni” përfshin, midis të tjerash i) të dhëna personale; ii) informacion të mbrojtur nga të drejtat e pronësisë intelektuale ose nga konfidencialiteti tregtar ose industrial; dhe iii) informacion që lidhet me sigurinë kombëtare ose me mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore ose instalimeve bërthamore.

2. Kur në kontekstin e kësaj Konvente, një palë kontraktuese siguron informacion të identifikuar nga ajo si i mbrojtur, siç përshkruhet në paragrafin 1, ky informacion përdoret vetëm për qëllimet për të cilat ai është siguruar dhe konfidencialiteti i tij duhet të respektohet.

3. Përmbajtja e debateve gjatë shqyrtimit të raporteve nga palët kontraktuese në çdo takim është konfidencial.

#### Neni 28 **Sekretariati**

1. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike (në vijim e referuar si “Agjencia”) siguron sekretariatit për takimet e palëve kontraktuese.

2. Sekretariati:

i) thërret, përgatit dhe zhvillon takimet e palëve kontraktuese;

ii) transmeton tek palët kontraktuese informacionin e marrë ose të përgatitur në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

Shpenzimet e bëra nga Agjencia për kryerjen e funksioneve të përmendura në nënparagrafët “i” dhe “ii” të mësipërm, përballohen nga Agjencia si pjesë e buxhetit të saj të rregullt.

3. Palët kontraktuese, me konsensus, mund të kërkojnë nga Agjencia të sigurojë shërbime të tjera në mbështetje të takimeve të palëve kontraktuese. Agjencia mund të sigurojë këto shërbime nëse ato mund të ndërmerren brenda programit të saj dhe buxhetit të rregullt. Nëse kjo nuk është e mundur, Agjencia mund të sigurojë shërbime të tilla, nëse është siguruar fond vullnetar nga burime të tjera.

### KAPITULLI 4 KLAUZOLA PËRFUNDIMTARE DHE DISPOZITA TË TJERA

#### Neni 29 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Në rastin e një mosmarrëveshjeje ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese që lidhen me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, palët kontraktuese këshillohen brenda kuadrit të një takimi të palëve kontraktuese, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

#### Neni 30 **Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi, aderimi**

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet në selinë e Agjencisë në Vjenë nga data 20 shtator 1994 deri në hyrjen e saj në fuqi.

2. Kjo Konventë është subjekt ratifikimi, pranimi ose miratimi nga shtetet nënshkruese.

3. Pas hyrjes së saj në fuqi, kjo Konventë do të jetë e hapur për aderim nga të gjitha shtetet.

4.i) Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim ose aderim nga organizata rajonale të një integriteti ose natyre tjetër, që siguron se çdo organizatë e tillë përbëhet nga një shtet sovran dhe ka kompetencën në lidhje me negocimin, përfundimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për çështje që mbulon kjo Konventë.

ii) Për çështje që janë brenda kompetencave të tyre, këto organizata në emër të tyre ushtrojnë të drejtat dhe përbushin përgjegjësitë, të cilat kjo Konventë ua atribuon shteteve palë.

iii) Kur bëhet palë në këtë Konventë, një organizatë e tillë i komunikon depozitarit të përmendur në nenin 34, një deklaratë që tregon përkatësinë nga shteti anëtar, cili nen i kësaj Konvente zbatohet për të, dhe shtrirjen e kompetencave në fushën e mbuluar nga këto nene.

iv) Organizata të tilla nuk kanë ndonjë votë shtesë për shtetet e tyre anëtare.

5. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit depozitohen pranë depozitarit.

#### Neni 31 **Hyrja në fuqi**

1. Kjo Konventë hyn në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit pranë depozitarit të njëzet e dy instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit, duke përfshirë instrumentet e shtatëmbëdhjetë shteteve, të cilat kanë të paktën një instalim bërthamor që ka arritur kriticitetin në një qendër reaktori.

2. Për çdo shtet ose organizatë rajonale të një integriteti ose natyre tjetër, e cila ratifikon, pranon, miraton ose aderon këtë Konventë pas datës së depozitimit të instrumentit të fundit që kërkohet për të përmbushur kushtet e vendosura në paragrafin 1, kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit pranë depozitarit të instrumentit të përshtatshëm nga ky shtet ose organizatë.

### Neni 32 **Amendimet ndaj Konventës**

1. Çdo palë kontraktuese mund të propozojë një amendament për këtë Konventë. Amendamenti i propozuar konsiderohet në një takim shqyrtues ose në një takim të jashtëzakonshëm.

2. Teksti i çdo amendamenti të propozuar dhe arsyet për të depozitohen tek depozitari, i cili i komunikon menjëherë propozimin të palët kontraktuese dhe të paktën nëntëdhjetë ditë para takimit për të cilin është paraqitur për shqyrtim. Çdo koment i marrë për një propozim të tillë qarkullohet nga depozitari tek palët kontraktuese.

3. Palët kontraktuese vendosin pas shqyrtimit të amendamentit të propozuar nëse ai duhet të miratohet me konsensus, ose në mungesë të konsensusit, ta paraqesin atë në një konferencë diplomatike. Një vendim për të paraqitur një amendament të propozuar kërkon votën e shumicës me dy të tretat e palëve kontraktuese që janë të pranishme dhe që votojnë në takim, duke garantuar që të paktën gjysma e palëve kontraktuese të jenë të pranishme në kohën e votimit. Abstenimi konsiderohet si votim.

4. Konferenca diplomatike për të shqyrtuar dhe miratuar amendamentet për këtë Konventë thirret nga depozitari dhe zhvillohet jo më vonë se një vit pas marrjes së vendimit të përshtatshëm në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni. Konferenca diplomatike bën çdo përpjekje për të siguruar që amendamentet janë miratuar me konsensus. Nëse kjo nuk është e mundur, amendamentet miratohen me shumicën e dy të tretave të të gjitha palëve kontraktuese.

5. Amendamentet në këtë Konventë të miratuara sipas paragrafëve 3 dhe 4 të mësipërm janë subjekt ratifikimi, pranimi, miratimi ose konfirmimi nga palët kontraktuese dhe hyjnë në fuqi për ato palë kontraktuese të cilat i kanë ratifikuar, pranuar, miratuar ose konfirmuar ato në ditën e nëntëdhjetë pas marrjes nga depozitari të instrumenteve përkatëse nga të paktën tre të katërtat e palëve kontraktuese. Për një palë kontraktuese, e cila ratifikon, pranon, miraton ose konfirmon më pas amendamentet e mësipërme, amendamentet hyjnë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pasi kjo palë kontraktuese të ketë depozituar instrumentin e saj përkatës.

### Neni 33 **Denoncimi**

1. Çdo palë kontraktuese mund ta denoncojë këtë Konventë me njoftim me shkrim drejtuar depozitarit.

2. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga depozitari ose në një datë tjetër të mëvonshme, siç mund të jetë përcaktuar në njoftim.

### Neni 34 **Depozitari**

1. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë është depozitari i kësaj Konvente.

2. Depozitari informon palët kontraktuese për:

i) nënshkrimin e kësaj Konvente dhe depozitimin e instrumenteve të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, në përputhje me nenin 30;

ii) datën në të cilën Konventa hyn në fuqi, në përputhje me nenin 31;

iii) njoftimin e denoncimit të Konventës dhe datën përkatëse, të bërë në përputhje me nenin 33;

iv) amendimet e propozuara për këtë Konventë të paraqitura nga palët kontraktuese, amendimet e miratuara nga konferenca diplomatike përkatëse ose nga takimi i palëve kontraktuese, dhe datën e hyrjes në fuqi të amendimeve të mësipërme, në përputhje me nenin 32.

Neni 35  
**Tekstet origjinale**

Originali i kësaj Konvente, tekstet e së cilës në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, janë njëloj autentike, depozitohet pranë depozitarit, i cili më pas i dërgon kopje të vërtetuara palëve kontraktuese.

**LIGJ**  
**Nr.10 382, datë 24.2.2011**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË DANIMARKËS PËR BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Danimarkës për bashkëpunimin për zhvillim”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6919, datë 8.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË DANIMARKËS MBI BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM**

Hyrje

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (tani e tutje referuar si “Shqipëria”) dhe Qeveria e Mbretërisë së Danimarkës (tani e tutje referuar si “Danimarka”),

*me dëshirën* e forcimit të kuadrit ligjor dhe institucional për bashkëpunimin e tyre për zhvillim;

- *duke pasur* si qëllim forcimin e lidhjeve të miqësisë ndërmjet të dy vendeve;

- *me dëshirën* për t’i fuqizuar këto marrëdhënie përmes zhvillimit, shtrirjes dhe thellimit të bashkëpunimit të tyre për zhvillim;

- *duke synuar* që të kontribuojnë për një rritje ekonomike dhe një zhvillim të qëndrueshëm e të barabartë nga ana shoqërore, si edhe drejt reformave politike, ekonomike e shoqërore të nevojshme që Shqipëria t’i përshtatet gjithnjë e më shumë strukturave të BE-së,

kanë rënë dakord për sa vijon:

## Neni 1 Detyrimet e palëve

1. Danimarka do të vendosë në dispozicion të Shqipërisë asistencë financiare, burime materiale, asistencë teknike dhe mundësi kualifikimi. Shqipëria do të sigurojë përdorimin me efikasitet të asistencës në fjalë dhe mundësive për kualifikim.

2. Kushtet dhe procedurat e veçanta, përfshirë detyrimet financiare dhe detyrime të tjera të të dy palëve përsa u përket projekteve dhe programeve të veçanta, dhe aktivitete të tjera të përbashkëta në bazë të kësaj Marrëveshjeje (tani e tutje referuar si “programet”) do të përcaktohen në çdo rast nga ana e palëve nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta, përfshirë marrëveshjet administrative të arritura nëpërmjet shkëmbimit të letrave (tani e tutje referuar si “marrëveshje të veçanta”) duke iu referuar në mënyrë të qartë kësaj Marrëveshjeje.

3. Në rast se ka mospërputhje midis marrëveshjes aktuale dhe marrëveshjes së veçantë, do të ketë përparësi kjo e fundit.

4. Në zbatimin e marrëveshjes aktuale, Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës është e autorizuar për të përfaqësuar Danimarkën dhe Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave është i autorizuar për të përfaqësuar Shqipërinë (tani e tutje referuar si autoritetet kompetente).

## Neni 2 Agjencitë zbatuese

1. Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, termi “agjencitë zbatuese” nënkupton çdo autoritet publik të huaj dhe çdo korporatë publike ose private të huaj, si dhe çdo organizatë qoftë publike, apo private, të pranuar nga ana e të dy qeverive dhe të kontraktuar nga ana e Danimarkës, për të zbatuar marrëveshjet specifike të referuara në nenin I, paragrafi 2, si më sipër.

2. Danimarka, përveçse kur bihet dakord ndryshe në marrëveshjet e veçanta, do të paguajë tarifat dhe kostot e agjencive zbatuese, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Danimarkës, duke përjashtuar kostot të cilat do të mbulohen nga ana e Shqipërisë, siç përcaktohet në paragrafin 3 më poshtë.

3. Lehtësirat e mëposhtme u akordohen agjencive zbatuese të huaja jorezidente nga ana e Shqipërisë:

- a) U jep atyre pa pagesë dhe pa vonesa të tepruara të gjitha lejet dhe autorizimet e nevojshme;
- b) I përjashton ato nga tatimi i të ardhurave ose çdo taksë apo detyrim tjetër i drejtpërdrejtë përsa i përket çdo page të dhënë ndaj tyre nga fonde dhe burime jashtë Shqipërisë për shërbimet e tyre brenda Shqipërisë sipas kësaj Marrëveshjeje;
- c) I përjashton ato nga detyrimi për t'i paraqitur autoriteteve shqiptare çdo lloj deklarate financiare apo tatimore të cilat i kërkohen personave dhe kompanive private përsa i përket të ardhurave të fituara në bazë të kësaj Marrëveshjeje;
- d) Nuk zbaton kufizime mbi monedhën apo shkëmbimin e valutave mbi fondet e dërguara në Shqipëri nga ana e agjencive të huaja për të zbatuar aktivitetet në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe lehtëson shkëmbimin dhe eksportimin e fondeve të tilla, si dhe hapjen e llogarive bankare; dhe
- e) I përjashton ato nga kërkesat për regjistrim profesional dhe pajisje me licencë, me përjashtim të rasteve kur ushtrojnë aktivitete biznesi që nuk përfshihen në objektin e kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 3 Personeli

1. Asistenca teknike e siguruar me kërkesë të Shqipërisë në bazë të kësaj Marrëveshjeje mund të jetë në formën e personelit teknik ndihmës (për detyra afatshkurtra apo afatgjata) të punësuar nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Danimarkës ose nga ana e agjencive zbatuese të përmendura në nenin 2, paragrafi 1, si më sipër. Sigurimi i shërbimeve të personelit të lartpërmendur (tani e tutje referuar si personeli) i nënshtrohet disponueshmërisë së personave të përshtatshëm, të kualifikuar dhe me përvojë në momentin e duhur.

2. Autoriteti kompetent shqiptar për çdo projekt/program i siguron në çdo rast autoritetit kompetent danez përshkrimin e plotë dhe titullin e punës së personelit të angazhuar nga ana e Ministrisë Daneze të Punëve të Jashtme dhe në raste të tjera, sipas nevojës, duke i përcaktuar detyrat e pozicionit me të cilin do të ngarkohet dhe shërbimet që do të realizohen, si dhe kualifikimet bazë dhe të dëshirueshme të kandidatit. Duhet të përcaktohet qartë në përshkrimin e punës nëse personeli do të ndër marrë funksione ekzekutive operacionale apo jo.

3. Autoriteti kompetent danez i siguron autoritetit kompetent shqiptar për secilin program/projekt të dhëna të nevojshme për vlerësimin e kandidatëve për pozicionet e referuara më sipër si kualifikime dhe përvoja të mëparshme profesionale.

4. Autoriteti kompetent shqiptar, për secilin program/projekt dhe autoriteti kompetent danez vendosin së bashku se në çfarë mase do të caktohen nga ana e Shqipërisë homologët për personelin e vënë në dispozicion ose mbi masa të tjera që do të ndërmerren për arritjen e objektivave.

5. Në realizimin e detyrave të tyre, personeli do të jetë nën drejtimin e autoriteteve shqiptare ose organizmave të tjerë për të cilat ata janë caktuar dhe i nënshtrohen ligjeve dhe rregullave të Shqipërisë, përveçse kur iu akordohen përjashtime të veçanta në bazë të marrëveshjes aktuale ose marrëveshjes së veçantë.

6. Shqipëria duhet të sigurojë se personeli i huaj dhe bashkëshortët apo personat në ngarkim do të gëzojnë mbrojtje të plotë me ligj, dhe të sigurojë më tej që personeli dhe bashkëshortët e tyre dhe fëmijët gëzojnë privilegje jo më pak të favorshme se ato të akorduara personelit të caktuar në Shqipëri nga vendet ose organizatat e tjera ndërkombëtare.

7. Në rast arrestimi apo ndalimi të personelit të huaj të vënë në dispozicion nga ana e Danimarkës, ose të bashkëshortëve dhe personave në ngarkim të tyre, apo në rast të proceseve gjyqësore të filluara ndaj personave të tillë, Ambasada Mbretërore Daneze në Shqipëri duhet të njoftohet menjëherë dhe duhet t'i jepet e drejta për të vizituar çdo person të ndaluar apo arrestuar. Personave të tillë duhet t'u jepet e drejta për t'u përfaqësuar me anë të një avokati të caktuar nga ana e ambasadës apo vetë personi në përputhje me ligjin dhe rregulloret e Shqipërisë.

8. Shqipëria është përgjegjëse për sigurimin e personelit të huaj, bashkëshortëve dhe personave në ngarkim. Në rast të një krize, e cila ndikon mbi sigurinë e shtetasve të huaj në Shqipëri, Shqipëria i siguron personelit në fjalë dhe bashkëshortëve dhe personave në ngarkim të tyre, lehtësira për riatdhesim në përputhje me kushtet jo më pak të favorshme se ato të siguruar personelit të caktuar në Shqipëri dhe bashkëshortëve dhe personave në ngarkim të tyre nga ana e vendeve ose organizatave të tjera ndërkombëtare.

9. Në rast se haset një situatë ose kusht i referuar në paragrafin 8 më sipër, të dyja qeveritë konsultohen me njëra-tjetrën dhe veprojnë në bashkëpunim të ngushtë për të minimizuar çdo rrezik apo dëm kundrejt personelit të huaj, bashkëshortët dhe personat në ngarkim të tyre ose për të minimizuar dëmin ndaj pajisjeve vetjake dhe kundrejt materialeve, pajisjeve dhe automjeteve të përdorura për të zbatuar programet/projektet në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

10. Personeli i huaj, duke vepruar në përputhje me udhëzimet e lëshuara nga Ambasada Mbretërore Daneze në Shqipëri në rast krize ose duke marrë masa paraprake të tilla të cilat gjykohen të drejta në këto rrethana dhe si rrjedhim kufizojnë raportimin për punën, nuk gjykohen si shkelje të detyrës në bazë të kontratës përkatëse.

11. Shqipëria gëzon të drejtën për të kërkuar tërheqje të çdo anëtari të personelit, puna apo sjellja e të cilit gjykohet e papranueshme. Para ushtrimit të një të drejte të tillë, Shqipëria konsultohet me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Danimarkës.

12. Danimarka gëzon të drejtën për të tërhequr çdo anëtar të personelit në çdo kohë. Para ushtrimit të një të drejte të tillë, Danimarka konsultohet me Shqipërinë për këtë qëllim, si dhe për masat për të siguruar zëvendësimin e shpejtë të personelit në fjalë nëse një gjë e tillë kërkohet nga Shqipëria, përveçse kur rrethana të jashtëzakonshme kërkojnë që personi të tërhiqet menjëherë.

13. Nëse bihet dakord midis autoriteteve kompetente, personeli mund të transferohet nga një vend ose funksion në tjetrin gjatë periudhës së detyrës.

14. Danimarka mbulon të gjitha pagesat, pagat dhe kostot e personelit në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Ministrisë së Punëve të Jashtme, përveçse kur mbulohen nga ana e Shqipërisë, siç përcaktohet në paragrafin 15 më poshtë.

15. Përsa i përket personelit, Shqipëria, përveçse kur bihet dakord ndryshe, siguron hapësira për zyra, transport, shërbime logjistike dhe pajisje të tjera të nevojshme në përputhje me kushtet e siguruara

personelit të caktuar në Shqipëri nga ana e vendeve ose organizatave të tjera ndërkombëtare. Shqipëria i siguron personelit leje për të munguar për shkak të pushimeve, për arsye shëndetësore, shtatzëni apo lindje në përputhje me kontratat respektive të punësimit.

16. Shqipëria angazhohet që personeli i huaj, bashkëshortët/et dhe personat në ngarkim të tyre:

a) të përjashtohen nga shërbimi kombëtar dhe çdo detyrim tjetër ushtarak;

b) t'u jepet e drejta të hapin llogari bankare, të përjashtuara nga çdo kufizim monedhe apo shkëmbimi valute që aplikohet për fondet e jashtme të futura në Shqipëri dhe t'i lejojë të shkëmbejnë dhe nxjerrin jashtë vendit fonde të tilla, si dhe çdo të ardhur nga pajisjet shtëpiake dhe personale të importuara dhe/ose shitura në përputhje me dispozitat e paragrafëve 17 dhe 18, si dhe

c) të përjashtohen nga kërkesat për regjistrim profesional dhe pajisje me licencë.

17. Shqipëria parashikon përjashtimin e personelit të huaj, bashkëshortët/tet dhe personat në ngarkim të tyre nga:

a) tatimi mbi të ardhurat personale ose çdo taksë apo detyrim tjetër i drejtpërdrejtë, përfshirë kontributet kundrejt skemës së sigurimeve shoqërore kombëtare përsa i përket çdo page të paguar ndaj tyre nga ana e Danimarkës për shërbimet e tyre në Shqipëri në bazë të kësaj Marrëveshjeje;

b) detyrimi për t'i paraqitur autoriteteve shqiptare çdo deklaratë financiare apo tatimore, e cila u kërkohet qytetarëve të Shqipërisë apo të huajve që banojnë në Shqipëri për pagesat e përmendura më sipër;

c) Të gjitha tatimet, taksat dhe detyrime të tjera përkatëse doganore që zbatohen mbi importin ose eksportin e pajisjeve shtëpiake dhe personale të reja, si dhe të përdorura për përdorim të zakonshëm ditor të familjes përfshirë një mjet motorik për përdorim vetëm nga ana e tyre të importuar nga ana e personelit, bashkëshortët/et dhe personat në ngarkim të tyre, brenda 6 muajve pas mbërritjes së tyre në Shqipëri, e detyrueshme të rieksporthet me mbarimin e shërbimit ose pasi të jenë paguar detyrimet dhe taksat në lidhje me çmimin e saj të tregut nëse do të ishte shitur brenda vendit, përveçse kur i shitet një personi që gëzon të njëjtat privilegje.

18. Në rast se një mjet motorik i përmendur më sipër dëmtohet përtej mundësisë për riparim me kosto të arsyeshme ose në rastin e kundërt humbet, pa neglizhencë, nga ana e personelit të huaj, bashkëshortët/et dhe personat në ngarkim të tyre, përjashtimet e përmendura në paragrafin përkatës aplikohen për importimin ose blerjen e një mjeti motorik të ri, pavarësisht nga afati kohor.

19. Në rast se një personel i huaj, bashkëshorti/ja i/e saj/tij dhe personat në ngarkim të tyre, për shkak të vjedhjes apo rrëmbimit, kanë humbur një apo më shumë sende personale (p.sh.: TV, video, radio, CD player, regjistruer, kasetofon, kompjuter etj.) dhe pasi të kenë siguruar një procesverbal të policisë lidhur me ngjarjen, ose kur një artikull është dëmtuar përtej mundësisë për t'u riparuar, Shqipëria lejon importimin ose blerjen e pajisjes së re, e cila zëvendëson pajisjen e vjedhur apo të dëmtuar, pavarësisht nga afati kohor.

20. Shqipëria duhet të trajtojë me përparësi kërkesat për viza falas për hyrje dhe dalje të shumta për personelin e huaj, bashkëshortët dhe personat në ngarkim të tyre, si dhe leje qëndrimi, leje të punës dhe leje të tjera të nevojshme për të gjithë kohëzgjatjen e detyrës.

21. Shqipëria jep ndihmesë për zhdoganimin e artikujve të përmendur në nenin 2 paragrafët 17 "c" dhe 18 (shih për këtë nenin 5).

22. Shqipëria lehtëson nxjerrjen e lejeve kombëtare të drejtimit të automjeteve për personelin e huaj, bashkëshortët/et dhe personat në ngarkim të tyre, të cilët zotërojnë një patentë të vlefshme nga Danimarka ose vend tjetër, ose lejon përdorimin e lejeve ndërkombëtare të drejtimit të automjeteve dhe më tej lehtëson regjistrimin e automjeteve për përdorim vetjak nga ana e personelit, bashkëshortët/et dhe personat në ngarkim të tyre.

#### Neni 4

#### **Detyrimet dhe dëmshpërblimet**

1. Shqipëria zhdëmton Danimarkën dhe personelin e saj për çdo humbje dhe detyrim që rrjedh nga veprimet ose mosveprimet kundrejt një ose disa personave të lartpërmendur brenda kuadrit të aktiviteteve, veprimeve ose operacioneve që përbëjnë ose zbatohen në vijim të kësaj Marrëveshjeje, dhe që i shkaktojnë vdekje apo dëmtime palëve të treta, apo dëmtojnë pasuri të tyre përsa kohë që detyrime të tilla për dëmtime nuk mbulohen plotësisht nga sigurimet dhe heq dorë nga çdo e drejtë për kërkesë për ndihmë ose për të ndërmarrë hapa proceduralë përsa u përket rasteve të tilla, përveçse në raste e shkeljeve të qëllimshme apo neglizhencës së plotë nga ana e një ose disa prej personave të lartpërmendur.

2. Me kusht që Shqipëria të zhdëmtojë Danimarkën ose një apo disa nga personat e lartpërmendur në rastin e kërkesës për ndihmë apo ndërmarrjes së hapave të tjera proceduralë lidhur me detyrimin për dëmin konform paragrafit 1 të këtij neni, Shqipërisë i jepet e drejta për të ushtruar dhe zbatuar çdo të drejtë për kërkesë për ndihmë, kundërkërkesë, siguracion, dëmshpërblim, kontribute ose garanci të cilat mund t'i jenë dhënë si e drejtë Danimarkës ose personelit.

3. Me kërkesë të Shqipërisë, Danimarka i siguron autoriteteve përkatëse shqiptare asistencën e duhur administrative dhe ligjore, me qëllim zgjidhjen e problemeve të tilla që mund të lindin nga zbatimi i paragrafëve 1 ose 2, si më sipër.

#### Neni 5 **Burime materiale**

1. Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, termi “burime materiale” nënkupton mallra, materiale, automjete, makineri, pajisje, pjesë këmbimi dhe çdo lloj artikujsh të tjerë të vëna në dispozicion nga ana e Danimarkës ose agjencive zbatuese për projektet sipas kësaj Marrëveshjeje ose çdo lloj tjetër artikujsh të dërguar në Shqipëri në bazë të marrëveshjeve të veçanta.

2. Danimarka, përveçse kur bihet dakord ndryshe në marrëveshjet e veçanta:

a) mbulon kostot aktuale, si blerjen, transportin dhe, sipas nevojës, siguracionin lidhur me dërgesën e artikujve;

b) përgjigjet për prokurimin dhe dërgimin e artikujve në Shqipëri;

c) kërkon që agjencitë zbatuese të njoftojnë agjencitë e caktuara në Shqipëri mbi datën e parashikuar të mbërritjes së dërgesës menjëherë mbas nisjes dhe iu përcjell agjencive në fjalë dokumentacionin e transportit, faturat dhe të dhëna të tjera përkatëse.

3. Shqipëria, përveçse kur bihet dakord ndryshe në marrëveshjet e veçanta:

a) njofton Danimarkën, nëse nevojitet, mbi dokumentacionin e duhur për zhdoganim dhe e informon Danimarkën mbi importin dhe procedurat e zhdoganimit që zbatohen në Shqipëri;

b) lëshon me shpejtësi, pa pagesë, licencat e nevojshme të importit dhe lejet e tjera mbi importin e artikujve;

c) përjashton artikujt nga, ose mbart kostot e të gjitha taksave doganore, taksave dhe detyrimeve të tjera përkatëse që lidhen me hyrjen në Shqipëri, si dhe përjashton artikujt nga të gjitha kufizimet dhe moslejimet mbi importin ose eksportin;

d) siguron marrjen e sigurt dhe të shpejtë, trajtimin, likuidimin, përcjelljen, si dhe magazinimin dhe transportin e mëtejshëm të artikujve të importuara;

e) ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe fillon çdo proces gjyqësor që mund të jetë i nevojshëm, përsa u përket pretendimeve për humbje ose dëmtim të pjesshëm, ose tërësisht të çdo dërgese të artikujve dhe njofton Danimarkën pa vonesë në raste të tilla.

f) lehtëson regjistrimin e mjeteve motorike të sjella në Shqipëri.

4. Artikujt, përfshirë automjetet e programit/projektit, kalojnë në pronësi të Shqipërisë në kohën që do të përcaktohet në secilën marrëveshje të veçantë ose më pas të rieksporthen. Megjithatë, artikujt duhet të jenë gjithmonë në përdorim ekskluziv të projektit përkatës, programit, ose aktiviteteve të tjera të përbashkëta, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, gjatë zbatimit të tyre.

#### Neni 6 **Mundësi trajnimi**

1. Bursa për studime në Danimarkë dhe vende të tjera do të vihen në dispozicion nga fondet e projektit dhe programit për kandidatët që i janë bashkuar aktiviteteve të financuara nga Danimarka dhe të emëruar sipas rregullave nga ana e Shqipërisë duke iu nënshtuar aprovimit të Danimarkës. Për më tepër, fonde të kufizuara janë të disponueshme për kurse dhe seminare në kuadër të çështjeve strategjike dhe politikave.

2. Bursat akordohen për studime të specializuara vetëm për kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet e tyre bazë. Programet studimore do të përgatiten zakonisht në anglisht.

3. Bursat mbulojnë:

a) koston e udhëtimit vajtje-ardhje nga vendi i detyrës drejt vendit të studimeve;

b) të gjitha shpenzimet e jetesës dhe tarifat e studimeve, librat dhe shpenzimet për artikuj të tjerë personalë gjatë periudhës së studimeve, në përputhje me rregulloret dhe normat aktuale të Danimarkës.



4. Shqipëria paguan pagën mujore të bursantit dhe pagesa të tjera sipas rregullave dhe kritereve të përcaktuar në legjislacionin e Shqipërisë.

5. Shqipëria garanton se bursanti do të mund të kthehet në pozicionin e tij/saj të mëparshëm në Shqipëri pas mbarimit të programit studimor.

#### Neni 7 **Vlerësimi**

Për ndjekjen dhe vlerësimin e bashkëpunimit, si dhe për planifikimin e bashkëpunimit në të ardhmen, autoritetet kompetente janë në dispozicion të njëra-tjetrës për konsultim reciprok dhe i japin njëra-tjetrës informacion siç mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme.

#### Neni 8 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mospërputhje apo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin e kësaj Marrëveshje do të zgjidhet me anë të diskutimit midis palëve.

#### Neni 9 **Ndryshimet**

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet apo plotësohet me pëlqimin e përbashkët të palëve kontraktuese nëpërmjet shkëmbimit të letrave.

#### Neni 10 **Hyrja në fuqi dhe përfundimi i Marrëveshjes**

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason muajin në të cilin të dy palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përmbushjen e të gjitha procedurave të nevojshme në vendet e tyre përkatëse.

2. Kjo Marrëveshje mbetet e vlefshme për një periudhë 5-vjeçare. Vlefshmëria e saj zgjatet automatikisht për periudhat pasuese 5-vjeçare, përveçse kur përfundohet nga secila palë duke njoftuar me shkrim 6 muaj para palën tjetër.

3. Kjo marrëveshje mbulon gjithashtu projekte tashmë të filluara me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Bërë në Tiranë më .....2010 në dy kopje origjinale në gjuhën angleze dhe të dy tekstet janë njëllloj autentike.

**VENDIM**  
**Nr.192, datë 9.3.2011**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË KRITEREVE PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT TË KOMPENSIMIT, PRONARËVE, NË TË HOLLA, PËR VITIN 2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pika 1 shkronja “d”, e 17, të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr.10 239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Subjektet e shpronësuara, prona e të cilave është njohur për kompensim, të kompensohen sipas radhës kronologjike, të përcaktuar nga numri dhe data e vendimit, vetëm nëse përmbushen këto kritere:

- a) Vendimi, që ka përcaktuar kompensimin e pronës, është përfundimtar;
- b) Vendimi, që ka përcaktuar kompensimin e pronës, është i ekzekutueshëm;
- c) Vendimi, për të cilin aplikohet, nuk është trajtuar asnjëherë me kompensim.

Në rastin e vendimeve, të cilat janë ndryshuar pjesërisht, për efekt klasifikimi, do të merret numri dhe data e vendimit bazë, që është më i hershëm në radhë kronologjike për njohjen, kthimin dhe kompensimin e asaj prone.

2. Kompensimi të bëhet për pronën e llojit truall, në bazë të çmimit të përcaktuar në hartën e vlerës, të miratuar sipas vendndodhjes së pronës, që kompensohet. Masa e kompensimit të jetë sipas skemës së mëposhtme:

- a) Për pronat e njohura për kompensim deri në 1500 (një mijë e pesëqind) m<sup>2</sup>, masa e kompensimit të jetë 200 (dyqind) m<sup>2</sup>.
- b) Për pronat e njohura për kompensim mbi 1500 (një mijë e pesëqind) deri në 3 000 (tre mijë) m<sup>2</sup>, masa e kompensimit të jetë 300 (treqind) m<sup>2</sup>.
- c) Për pronat e njohura për kompensim mbi 3 000 (tre mijë) deri në 5 000 (pesë mijë) m<sup>2</sup>, masa e kompensimit të jetë 400 (katërqind) m<sup>2</sup>.
- ç) Për pronat e njohura për kompensim mbi 5 000 (pesë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) m<sup>2</sup>, masa e kompensimit të jetë 500 (pesëqind) m<sup>2</sup>.
- d) Për pronat e njohura për kompensim mbi 10 000 (dhjetë mijë) m<sup>2</sup>, masa e kompensimit të jetë 600 (gjashtëqind) m<sup>2</sup>.

3. Subjektet, që kanë depozituar kërkesat e tyre në vitet 2006, 2007, 2008, 2009 dhe që vërtetojnë kryerjen e pagesës, nuk paguajnë tarifën e aplikimit për vitin 2011.

4. Subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë pranë AKKP-së dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesën për kompensim në të holla, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- b) Deklaratën për pranimin e kritereve për kompensim dhe të kushteve të tjera, që lidhen me to, sipas formularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- c) Titullin për njohjen dhe kompensimin e pronës, që, sipas rastit, mund të jetë vendim i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, vendim i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe vendim i gjykatës, në rastet kur vendimet e sipërcituara janë ndryshuar në rrugë gjyqësore.
- ç) Planvendosjen përkatëse, si edhe planin e rilevimit të pronës së njohur për kompensim në fragmentin e hartës treguese të regjistrimit të pasurive.
- d) Dëshminë e trashëgimisë.
- dh) Prokurën e posaçme, të nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të subjektit të shpronësuar.

e) Dokumentin e identifikimit (letërnjoftim apo pasaportë) të përfaqësuesit të pajisur me prokurë.

ë) Mandatpagesën.

5. Në rastin e kërkesave të paraqitura në AKKP, në mbështetje të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.1343, datë 4.6.2008 “Për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit të pronarëve, në të holla, për vitin 2008” dhe nr.487, datë 6.5.2009 “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit, të pronarëve, në të holla, për vitin 2009”, të cilat nuk janë pranuar nga AKKP-ja për pamjaftueshmëri fondi, kërkuesit duhet të pohojnë vullnetin e tyre, nëpërmjet një kërkesë të re, për kompensimin, të shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 6 të këtij vendimi.

6. Subjektet, që kanë aplikuar për kompensimin në të holla, në vitet 2008 dhe 2009, të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën për kompensim financiar, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Deklaratën për pranimin e kriterëve për kompensim dhe të kushteve të tjera, që lidhen me to, sipas formularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Dëshminë e trashëgimisë, nëse ka ndryshime në rrethin e trashëgimtarëve të ligjshëm të subjektit të shpronësuar, sipas radhës së trashëgimtarëve, të përcaktuar në Kodin Civil.

ç) Prokurën e posaçme, nëse ajo e paraqitur në vitin 2008 apo 2009, ka kufizimin në kohë për tagrin e tërheqjes së shumës në të holla apo kur rrethi i trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar ka ndryshuar.

7. AKKP-ja shqyrton dokumentacionin e subjekteve, që kërkojnë kompensim në të holla, duke kryer veprimet e mëposhtme:

a) Verifikon dosjen dhe vendimin përkatës, të dhënë nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

b) Kërkon nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që, brenda 10 (dhjetë) ditëve, të konfirmojnë, për:

i) regjistrimin e vendimit përkatës në ZVRPP;

ii) përcaktimin e gjendjes juridike aktuale të pronës dhe verifikimin nëse ajo ka ndryshuar nga momenti i daljes së vendimit me të cilin aplikohet;

iii) verifikimin e ushtrimit të së drejtës së parablerjes.

c) Kryen verifikimin në terren të gjendjes së pronës dhe mban procesverbalin përkatës.

d) Përgatit planvendosjen e pronës që kompensohet dhe cakton:

i) në hartën e vlerës, zonën ku ndodhet prona;

ii) në bashkëpunim me subjektin e shpronësuar, pjesën e pronës, që kërkohet për t’u kompensuar, sipas masës që përcaktohet në pikën 2 të këtij vendimi, dhe i kërkon përfaqësuesit me prokurë të nënshkruajë për pjesën, që kompensohet.

dh) Llogarit vlerën e sipërfaqes, që kompensohet.

d) Përgatit vlerësimin ligjor, ku shpjegohen me hollësi për secilin subjekt kërkues:

i) vlefshmëria e vendimit të paraqitur nga kërkuesi;

ii) konfirmimet e zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

iii) vlerësimi i pronës për kompensim.

ë) Merr vendimin për pranimin apo refuzimin e kërkesës për kompensim të subjektit të shpronësuar.

f) U dërgon subjektit të shpronësuar, Avokaturës së Shtetit dhe zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme kopje të vendimeve të marra, për t’u dhënë mundësi të ushtrojnë kompetencat ligjore.

g) Shpall listën e subjekteve fituese.

gj) Kryen veprimet me thesarin dhe bankën për kalimin e fondit të kompensimit në të holla, në emër të subjektit të shpronësuar, përfitues të kompensimit, apo përfaqësuesit të tij me prokurë, në përputhje me procedurat për zbatimin e buxhetit të shtetit.

8. Procesi i regjistrimit/pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 (pesë) ditë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe vazhdon për 1 (një) muaj.

9. I gjithë procesi i trajtimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara duhet të kryhet në përputhje me këtë vendim dhe me afatin ligjor, të përcaktuar në nenin 17, paragrafi 2, të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

10. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre nga subjektet e shpronësuara, në zbatim të këtij vendimi, sjell përjashtimin e menjëhershëm të këtyre subjekteve nga procedura e kompensimit në të holla dhe i ngarkon ata me përgjegjësi penale, sipas ligjit.

11. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**KËRKESË  
PËR KOMPENSIMIN E PRONËS**

Drejtuar: AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE

Data e paraqitjes së kërkesës \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2011

Subjekti i shpronësuar:

.....	.....	.....
Emri	Atësia	Mbiemri

Personi me prokurë që paraqet kërkesën:

.....	.....	.....
Emri	Atësia	Mbiemri

Adresa e personit me prokurë:

.....	.....	.....
Qarku	Rrethi	Qyteti/fshati

.....	.....	.....
Lagja	Rruga	Nr.i banesës

.....	.....	.....
Telefon	Celular	e-mail

Kërkoj kompensimin e pronës me të holla, sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2011 “Për miratimin e procedurave të ndarjes së fondit të kompensimit në të holla, për vitin 2011”.

Kërkuesi

\_\_\_\_\_

(emri,atësia,mbiemri,nënshkrimi)

Shënim. Ky formular është dokument zyrtar. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre passjell përjashtimin e menjëhershëm nga çdo procedurë e mëtejshme, si dhe përgjegjësi penale sipas ligjit.



**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 21.3.2011  
Doli nga shtypi më 21.3.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë